

Rruga e Arbërit



Botim Periodik i Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibrane". Viti II i Botimit. Nr. 10(18). Tetor 2007 Çmimi: 50 lekë, 20 dinarë

Mirësevjen Oda Dibrane!

Nga data 2 dhe 3 nëntor do të mbahet në qytetin e Peshkopisë edicioni i 12-të i Festivalit "Oda Dibrane". Festivali organizohet nën përkujdesjen e Bashkisë së qytetit të Peshkopisë (Qendra Kulturore Dibrë), Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Pjesëmarrës në këtë festival do të jenë grupe dhe shoqëri kulturore interpretues të folklorit nga Kosova, trojet shqiptare të Maqedonisë, të Malit të Zi dhe grupe nga qarqe të ndryshme të vendit. Në këtë Festival ka njoftuar pjesëmarrjen e tij për të nderuar festivalin, këngëtari i mirënjohur i trojeve shqiptare, Ilir Shaqiri, i cili për nder të festivalit do të bëjë edhe paraqitjen e parë të një kënge për pavarësinë e Kosovës të kompozuar nga Përparim Tomçini. E veçanta e këtij festivali krahasuar me festivalet e mëparshme Odës Dibrane të këtij viti do t'i mungojë koncerti i ashtuquajtur i mirëseardhjes, i cili organizohet nga Qendra Kulturore Peshkopi për nder të pjesëmarrësve. Mungesa e kësaj tradite të mirë nuk duket se është shenjë e mirë as për vetë Odën Dibrane, e cila po shkon vit pas viti drejt rrëgjimit. Sa kohë që Oda Dibrane nuk do të kthehet në një "pronë" e të gjithë qytetarëve ku të gjithë të jenë kontribuesit dhe përjetuesit e kësaj feste ajo gjithmonë do të jetë e rrezikuar që vit pas viti të humbasë diçka gjersa një ditë të mos ketë fare Odë Dibrane. Mendojmë se është koha e fundme që organizatorët dhe administrata lokale të mendojnë për forma të reja të organizimit të këtij aktiviteti të shndërruar tashmë në një institucion kulturor me vlera mbarëkombëtare.

Qoftë edhe për faktin se shumë shqiptarë nga mbarë trojet shqiptare mblidhen e shihen sy në sy me njëri-tjetrin, të çmallen, të përshëndetën e të diskutojnë për të ardhmen e tyre.

Letër e hapur Qeverisë së Shqipërisë, Qeverisë së Kosovës, Lidhjes Shqiptare në Botë, Këshillit Kombëtar Shqiptaro-Amerikan dhe biznesmenëve shqiptarë

Libri që duhet përkthyer dhe shpërndarë urgjentisht në tërë botën

Nga Rexhep TORTE
FAQE 10



Foto: Gentjan Vranici

VISARE NGA ODA DIBRANE / FJALË NË SEPETE

Qitapi i Hoxhë Nelës

Nga NAIM PLAKU - Faqe 11

Rruga e Arbërit, zhvillohet tenderi për ndërtimin e segmentit Bulqizë - Ura e Cerencit

Italianët në garë për rrugën Bulqizë-Bllatë

Më datë 18, 19, 20 tetor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve është realizuar tenderi për fillimin e punimeve në segmentin Bulqizë - Ura e Cerencit. Punimet, sipas burimeve zyrtare, do të zhvillohen në tre lote të ndarë nga njëri - tjetri dhe do të zgjasin 24 muaj.

FAQE 3



Besëlidhja dibrane nuk u respektua

FAQE 10

VESHTRIME MITOLOGJIKE

Traktimi mitologjik i legjendës shqiptare mbi ylberin

Nga AGRONTUFA

Brezi (në disa zona të Dibrës së Epërme dhe Lumës quhet *shoka*), paraqet në vetvete një element të pandarë të kostumit nacional në një shumicë popujsh.

FAQE 6

ARKEOLOGJI

BURIMI - një nga vendbanimet neolitike më të hershëm në Shqipëri

Prof. ass. dr. ADEM BUNGURI

Në periudhën 27 gusht-12 shtator 2007 në vendbanimin neolitik të Burimit u kryen gërmime arkeologjike me karakter kontrolli.

FAQE 8-9

REPORTAZH

Udhëtim mes kontrastesh dhe rrugësh të mbyllura

Nga ABDURAHIM ASHIKU
FAQE 4-5

TURIZËM

Golloborda si destinacion turistik

Nga VITA KOJA*

Turizmi është një dukuri që shoqërohet me spostime njerëzve nga një rajon që quhet destinacion emetues, drejt një rajoni tjetër (destinacioni pritës) për një kohë të caktuar...

FAQE 7

SPORT

Gjetan Keta, fitues i Turneut European në K1-Rules, Thai & Kickbox

FAQE 12

Investime në minierën e Bulqizës

Nëntori do t'i gjejë minatorët e Bulqizës brenda ambienteve të minierës. Investimi i nisur prej kohësh nga firma koncesionare ka përmirësuar ndjeshëm kushtet teknike të punës, çka premtori më shumë kushte sigurie në punë për minatorët e kësaj miniere. Investimi i firmës "Albanian Chrome ACR" është shtrirë tashmë në 5 nivelet e minierës. Dhe miniera e kromit të Bulqizës është kthyer tashmë në një kanion të madh ndërtime nëntoksor, ku po kryhen punime intensive në disa nivele, me qëllim rritjen e sigurisë në punë. Burime nga kompania "Albanian Chrome ACR" bëjnë me dije se po punohet aktualisht në të gjitha nivelet. Ndërhyrja më thelbësore prek sistemin energo-mekanik, për të arritur një standard më të mirë të kushteve të punës të minatorëve dhe sigurisë teknike në këtë minierë. Specialistët thonë se ndërhyrja që po bëhet në këtë sistem përfshin riparimin e portave në nivelet 12 dhe vendosjen e stakuesve të portave, riparimin e platformave, kontrollit e paisjeve mbrojtëse të tensionit të lartë, zëvendësimin e kafazeve të disa puseve, instalimin e pajisjeve elektrike. Në pesë nivelet e minierës po punohet kryesisht në përforsimin e armatimeve mbrojtëse. Pjesë e këtyre ndërhyrjeve që po bëhen aktualisht në minierën e Bulqizës është dhe bllokimi i punimeve të vjetra dhe ndërtime të rrugëdaljeve. Në qoftë se sipas burimeve nga kompania koncesionare punimet në nivelin e 12 pritet të mbyllet më 19 nëntor, në nivelin e 13 punohet në armatimin e Dishenterisë, i cili kushtëzon programimin dhe realizimin e punimeve të tjera në këtë nivel...

Larg zhurmës së mediave, kompania "Albanian Chrome

Larg zhurmës së mediave, kompania "Albanian Chrome ACR" ka ndërmarrë investime të rëndësishme për të përmirësuar cilësinë e kushteve të punës dhe të sigurisë në minierë

ACR" ka ndërmarrë investime të rëndësishme për të përmirësuar cilësinë e kushteve të punës dhe të sigurisë në minierë, në përputhje të plotë me vlerësimin e Repartit të Inspektim Shpëtim Miniera. Duke i dhënë jetë një plani për përmirësimin e treguesve të punës në minierën e kromit në Bulqizë, si dhe në përmirësimin e kushteve të punës në minierën e kromit, duke garantuar kështu respektimin e kushteve të sigurisë në minierë, si dhe atyre të punës. Në minierën e Bulqizës punësohen aktualisht 660 punonjës. Kompania "Albanian Chrome ACR" është e angazhuar që të investojë për një periudhë 4 vjeçare rreth 17 milion euro në sektorin minierar në Shqipëri. Konsorciumi i përbërë nga kompanitë "DCM", "DECOMetal GmbH dhe "Terëingo" përfaqëson një grup të rëndësishëm industrial të nxjerrjes dhe përpunimit të ferroaliazheve, i cili gëzon një rrjet të gjërë marketingu me zyra në Rusi, Austri, Ukrainë, Kinë, USA, Kanada, Emiratet e Bashkuara Arabe, Afrikë të Jugut etj. Ky investim në Bulqizë është një ogur i mirë për ato minatorë që kanë lidhur jetën e tyre dhe të vetë fëmijëve me minierën e Bulqizës.

Grazhdan: Nis viti i ri shkollor pa dyer e dritare

Viti i ri shkollor ka filluar, edhe pse mungesa e librave ka qenë e dukshme. Nxënësit e Grazhdanit janë pa godinë shkollore ose kanë një godinë që çdo gjë mund të jetë, vetëm shkollë nuk mund të quhet. Godina që quhet shkollë është ngritur në vitin 1948 me qerpiç, ashtu siç ngriheshin dhe ndërtesat e banimit shpesh në Dibër. Sot kjo godinë është krejt e rënuar. Muret janë gërryer nga shiu dhe era dhe shkollës i mungojnë dyer dhe dritare, si dhe për mbulesë më së shumti ka plasmë. Shkollat aktualisht ka 70 nxënës, ku dhe për banjo në shkollë nuk bëhet fjalë. Nxënësit brendin fushave, saqë dhe vonohen për të ardhur në orarin e mësimave. Mësueset nuk shprehen nga frika e ndonjë pushimi nga puna, por sipas një burimi nga gazeta "Shqip" e datës 6 tetor 2007, fondi për ndërtimin e shkollës fillore në Grazhdan ka dalë dhe ajo duhej mbaruar brenda këtij viti. Po sipas kësaj

gazete, fondi i kësaj shkolle "fluturoi" në Pocerst". - E gjitha kjo ndodh për arsye se na quajnë bastion të partisë socialiste, - shprehen si nën zë mjaft banorë të Grazhdanit. Sot godina ekzistuese nuk ka qoftë dhe një karrige ku të ulet mësuesja, bangat janë të gjitha të shkatërruara. Vogëlushët në stinën e ftohtë të dimrit mblidhen skrupull dhe ashtu mundohen të mësojnë, se shkolla është pa dyer dhe dritare. I ftohti futet ngado dhe mësimi pastaj kuptohet vetvetiu sesi mund të zhvillohet në këtë shkollë fillore. Kjo nuk ka ndodhur sot. E njëjta situatë ka vite që ndodh në Grazhdan. Prindër dhe mësues pyesin me çudi. A do të ndërtohet godina në këtë fshat? Në qoftë se fshati është bastion i majtë, siç shprehen pushtetarët, çfarë kusuri kanë vogëlushët, të cilët ende nuk kanë njohuri fillestare mbi pluralizmin dhe partitë politike që veprojnë në Shqipëri?!

REPORTAZH - Vazhdon tkurrja e Dibrës së Madhe

Nga REXHEP TORTE

Gryka e Radikës nëpër të cilën kalon lumi Radikë, lumi më piktoresk dhe më i pastër në Ballkan e më gjerë, nëpër rrugëtimin e tij gjashtëdhjetë kilometrash nga burimi i tij rënzë Mavrovës e deri në Dibër, kalon nëpër një kanion gjarpërues dhe me bukuri mahnitëse. Megjithatë, ky kanion i bukur i lumit Radikë, tashmë nuk ndodhet në administrim të Dibrës. Administrimi i Dibrës mbi lumin Radikë nga dhjetëra kilometra është reduktuar në disa qindra metra, përkatësisht pak më larg se Banja e Kosovrastit.

Ky është edhe një shembull konkret dhe i pakontestueshëm i politikës gati qindvjeçare antidibrane e që nuk ka të ndalur as sot e kësaj dite.

Kufiri në Dibër të Madhe është vendosur me insistimin hegjonist ruso-serb dhe me mbështetjen e padrejtë të Konferencës së Ambasadorëve në Londër në vitin 1912-1913, gjë që është dëshmuar edhe në Konferencën e Paqes në Paris në vitin 1919-1920. Me këtë, krahina e Dibrës dhe sofa dibrane u ndanë më dysh. U nda Dibra e Madhe nga trugu stërgjyshëror dhe mbeti në Maqedoni, ndërsa Dibra e Vogël-Peshkopia, Bulqiza e Mati që administroheshin nga Dibra e Madhe mbetën në shtetin amë, Shqipëri.

Kjo përbën edhe teposh-tëzën e Dibrës së Madhe, që nuk po ndalet edhe sot e kësaj dite.

Dibra e Madhe iu mor Shqipërisë

Shkrimtarja amerikane Rouz Wajder asokohe shkruante se "Dibra iu mor Shqipërisë, siç nxirret me thikë sythi i një patateje. Kjo shkëputje bëri të ndahet bujku prej arës, bagëtia prej kullotës, fshati prej mullirit, blerësi nga tregu, duke i prerë tërë burimet e jetës".

Para se të vendosej ky kufi famëkeq, Dibra e Madhe ish-



Urë e dikurshme mbi lumin Radika

Ia morën edhe Grykën e Radikës

Maqedoni. Politika maqedonase-jugosllave në vazhdimësi filloi realizimin e projektit për tkurrjen e mëtutjeshme të Dibrës së Madhe. Ky projekt famëkeq filloi të realizohet nëpërmjet të ashtuquajturave ndarje territoriale. Me sa kam arritur në gjurmimet e mia, këto ndarje territoriale janë bërë në vitin 1953, 1962, 1965, 1996 dhe e fundit në vitin 2003.

Meqë nga Shqipëria nuk kishin më se çka të merret, administrata jugosllavo-maqedonase e pas mëvetësimin, administrata maqedonase, nëpërmjet këtyre ndarjeve territoriale filloi edhe copëtimin dhe marrjen graduale dhe gati të tërësishme të administrimit të Dibrës mbi Grykën e Radikës, duke krijuar administrata të reja komunale të Rostushës dhe Mavrovës dhe të Qendrës së Zhupës, nga njëra anë dhe duke mos anashkaluar edhe tkurrjen administrative edhe nga ana e Strugës. Dibra sot ka mbetur me 14 mijë kilometra katrorë dhe me afër 20 mijë banorë.

Dibra e Madhe ka mbetur edhe pa Grykën e Radikës

Dikur Dibra e Madhe, sot ka mbetur edhe pa Grykën e Radikës, për të dëgjuar me mallëngjim vetëm këngën e "Hajredin Pashës" dhe vargjet "Hajredin Pasha po vjen Radikës. - Çka po bëjnë këto malet e Dibrës-Bëjnë xhelis në Fushë Gjoricës-Turkut Dibrën mos me ia lënë- Hajredin Pasha ku e ke lënë ushërinë Grykë të Radikës m'i kanë grirë, -jo ma pak se dymbëdhjet mijë".

Kjo tkurrje, përveç saktosjes territoriale, i ka sjellur Dibrës edhe dëme të mëdha në zhvillimin ekonomik dhe bujqësor. Si pasojë të tërë kësaj kemi një mërgim intensiv në tërë botën e më së shumti gati 15 mijë dibranë që jetojnë e punojnë në SHBA.



Pamje e Grykës së Radikës që i ka mbetur Dibrës

KËSHILLI BOTUES I GAZETËS

Drejtor: RAKIP SULI. Kryeredaktor: SHAQIR SKARRA. Redaksia: Hajri Mandri, Prof. Dr. Bashkim Lleshi, Prof. Dr. Shaban Sinani, Bujar Karoshi, Rexhep Torte, Dukagjin Hata, Dr. Hasan Leka, Mirvet Lala, ADRESA E GAZETËS: Blloku i banesave "Gintash", market "KEN", Laprakë. Tel.068 31 19 232. Tel: (04) 357 179. E-mail: lid_gazeta@yahoo.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin qëndrimin e redaksisë dhe Shoqatës "LID".

Shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë", PROCREDIT BANK. Nr. Llog: Në lek 13-661344-0001. Euro 13-661344-0102. USD 13-661344-0203.

Rruga e Arbërit, zhvillohet tenderi për ndërtimin e segmentit Bulqizë - Ura e Cerencit

Më datë 18, 19, 20 tetor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve është realizuar tenderi për fillimin e punimeve në segmentin Bulqizë - Ura e Cerencit. Punimet, sipas burimeve zyrtare, do të zhvillohen në tre lote të ndarë nga njëri - tjetri dhe do të zgjasin 24 muaj.

Për të sjellë tek lexuesi një informacion të detajuar, redaksia do të botojë pjesë-pjesë (me shkurtime) projektin me specifikimet teknike, të hartuar nga firma InfraTransProjekt Shpk, me drejtues, z. Faruk Kaba. Ky botim bëhet edhe për të sjellë tek lexuesi një transparencë në këtë drejtim, duke kërkuar gjithashtu që sa më parë të nisim punimet edhe në segmente të tjera të Rrugës së Arbërit.

A - SPECIFIKIMET E PERGJITHSHME SEKSIONI 1 TE PERGJITHSHME DHE PARAPRAKE

1.01 Paraprake

Kushtet e Kontrates, Vizatime e projektit dhe Preventivi (tabela e volumeve) do të lexohen në lidhje me keto Specifikime dhe cështjet të cilave u referohen, cështjet që tregohen apo pershkruhen në secilin prej tyre nuk perseriten detyrimisht në të treja rastet.

Në raste mosperputhesh në lidhje me të njëjten cështje midis këtyre Dokumenteve, rendi mbizotëruar do të jete si me poshte:

- Oferta dhe Shtojcat e ofertes
- Kushtet e Kontrates, Pjesa C
- Kushtet e Kontrates, Pjesa B
- Specifikimet e Vecanta
- Specifikimet e pergjithshme
- vizatime projekti
- preventivi (tabela e volumeve)

1.04 Referencat

Standardet e references jane ato italjane CNR, UNI dhe ato te Ministrise te Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (per rastet e Betonit te armese dhe paranderjes). Standardet e vendeve te tjera te EEC dhe ato te Shteteve te Bashkuara (BSS, AFNOR, ASTM, AASHTO etj) konsiderohen si ekuivalente.

1.05 Klauzola qe nuk aplikohen

Cfaredo Klauzole e Specifikimeve qe lidhet me punime apo materiale qe nuk kerkohen ne Preventiva (tabela e volumeve) do te konsiderohet si e pa aplikueshme.

1.07 Informacioni ne lidhje me gropat e proves

Informacioni ne lidhje me pozicioni e shpimet dhe gropat per prove te Kantierit dhe pershkrimi i dherave dhe materialeve te ndryshme jepet tek vizatimet e projektit. Kontraktori mendohet se e ka marre dhe vleresuar informacionin gjate pergatitjes se ofertes se tij, si edhe ka bere prova te tjera qe ai i ka menduar si te nevojshme. Asnje kerkese per kompensim (ankese) per pagese shtese nuk do te merret parasysh nga Kontraktori mbi argumentin qe informacioni ka qene i pamjaftueshem, jo i sakte apo qe te nxjerr ne perfundime te

Italianët në garë për rrugën Bulqizë-Bllatë

Kryeministri Berisha ka pritur në fund të muajit tetor në zyrën e tij përfaqësues të "Bondcom", një grup financues ky nga veriu i Italisë. Ata i kanë shprehur kryeministrit interesin për të sjellë në Shqipëri disa prej investimeve, të cilat kjo kompani po i aplikon edhe në Rumani, në fushën e energjetikës, të përpunimit të mbetjeve urbane, të ndërtimit të rrugëve, por edhe në fushën e bujqësisë.

Pasi kanë prezantuar projektet e tyre, përfaqësuesit e "Bandcom" i kanë bërë me dije kryeministrit Berisha se e kanë gati tashmë financimin për të filluar sa më parë punën. Ata janë shprehur gjithashtu se janë të gatshëm të marrin pjesë në tenderin e rrugës së Arbërit dhe në atë të rrugës Korçë- Qafë Thanë.

Pasi është njohur me projektet e tyre, kryeministri Berisha i ka falënderuar përfaqësuesit e kompanisë për interesin që shprehën për të investuar në Shqipëri. Pasi u ka përshkruar panoramën e klimës pozitive të biznesit në vend, kryeministri u ka garantuar gatishmërinë e administratës shqiptare për të mbështetur këto projekte.

Kjo tregon tashmë se Rruga e Arbërit është nën vëmendjen e investitorëve të huaj dhe nuk do jetë e largët dita kur ëndrra mbarëdibrane të bëhet realitet.



gabuar.

1.08 Furnizimi me uje

Perpara se te dorrezoje oferten, Kontraktori do te beje nje investigim nese ka uje te majftueshem per qellimin e Punimeve te tij dhe do te konsultohet dhe do te rregulloje me autoritetet perkatese, si edhe do te marre parasysh te gjitha aspektet ligjore. Kontraktori do te jete plotesisht pergjegjes per furnizimin e sasise se mjaftueshme te ujit te cilesise se specifikuar gjate gjithë kohes se Kontrates. Kostot e furnizimit me uje do te merrren si te mbluara ne cmimet dhe perqindjet e Kontrates.

1.09 Kushtet atmosferike dhe permbytjet

Do te merret si e mireqene qe Kontraktori gjate pergatitjes se ofertes se tij do te kete marre parasysh te gjitha kushtet e mundshme atmosferike dhe rastet e permbytjeve ne kohen e perfundimit si edhe gjate Punimeve Permanente dhe te Perkohshme. Kontraktori nuk i takon asnje pagese shtese si pasoje e ndodhjes, vazhdimesise apo efektit te ererave te forta, bores, acarit, shirave dhe permbytjeve, temperaturave apo lageshtires apo si pasoje e kushteve te tjera meteorologjike apo hidrologjike.

1.10 Vizatimet e kontrates

Vizatime e Kontrates paraqiten ne Seksionin X te ketyre Dokumenteve te Tenderit. Ketu nuk do te aplikohet asnje vizatim qe lidhet me struktura standarde/tip apo me punime tipike ku nje pjese e se ciles apo e tera nuk kerkohet nga Preventivi (tabela e volumeve) apo qe eshte pjese e Klauzoles 51 te Kushteve te Pergjithshme.

1.11 Piketimi

Piketimi do te behet ne perputhje me Vizatimet e projektit te dhena nga Supervizori apo sipas instruksioneve te Supervizorit. Megjithate, Kontraktori do te pergjigjet per kryerjen e studimit fillestar mbi gjurmen e rruges ekzistues dhe do te pergatise

vizatimet e projektit te detajuar te ndertimit, dhe te detajeve te propozuara te ndertimit per aprovim te Supervizorit.

1.12 Kuotat

Kuotat e treguara ne Vizatimet e projektit lidhen me piketat te perhershme te rruges se Arbërit, Segmenti Bulqize - Bllate (Ura e Cerencit) dhe fiksimit e bera ne teren dhe qe dorezohen seshashku me vizatimet e ketij projekti.

1.13 Programi i Punimeve dhe Punimeve te Perkohshme

1. Duke iu referuar Klauzoles 14 te Kushteve te Kontrates, programi i punimeve te Kontraktorit duhet te permbaje detajet e meposhtme:

- Radha e punimeve
- Ecurine e planifikuar (grafiku i punes)
- Kapacitetet dhe llojet e impjan- teve te propozuara
- Detajet e metodave qe do te perdoren
- Detajet e punimeve te perkohshme
- Te dhena te detajuara mbi fuqine punetore, te kualifikuar ose jo

2. Punimet do te zbatohen ne menyre te tille qe te sigurojne perfundimin e njepasnjeshem dhe te plote te zerave te punest. Radha e zbatimit te Punimeve do te varet nga ndryshimet e mundshme, te justifikuara, qe do te behen nga Supervizori.

3. Kontraktori do t'i jape Supervizorit per aprovim vizatimet e projektit ku tregohet planimetria (gjurma), si edhe nje ide te pergjithshme te Punimeve te Perkohshme qe ai propozon te realizoje per qellimin e Kontrates duke perfshire, por pa u kufizuar ne:

- Kantieri, duke perfshire akomodimin e stafit dhe fuqise punetore dhe stafin e Supervizorit, ne rast se kerkohet;
- zyrrat
- ofcinat
- magazinat
- impjanti i thyerjes se inerteve dhe impjanti i prodhimit te asfalto betonit etj., ne rast se ka
- Impjanti i prodhimit te betonit dhe impjanti i parafabrikimit, ne

rast se ka.

Kontraktori nuk do te paguhet veç per kostot e mobilizimit dhe çmobilizimit, primet per garancite bankare, sigurimet, duke perfshire dhe sigurimin e paleve te treta, shtesat, fitimet apo cfaredo lloj kostoje apo tarife tjeter, apo per punime qe lidhen me sa me siper, me perjashtim te rasteve kur çmimet per njesi per to jane percaktuar ne menyre specifike tek Preventivi (tabela e volumeve) apo jane identifikuar shprehimisht ne Kontrate per t'u paguar.

4. Kontraktori do ta perfshije pagesen e Punimeve te Perkohshme ne cmimet e tij, me perjashtim te zerave te Preventivit (tabela e volumeve).

Ne rast se per cfaredo aresye, Supervizori kerkon sherbime dhe mirembajtjen e zyres, laboratorit, mjeteve dhe pajisjeve te komunikimit te tij per nje periudhe me te gjate nga ajo qe eshte parashikuar ne kohen e Kontrates, Kontraktori do t'i kerkohet te beje kete gje. Pagesat per sherbime dhe mirembajtje te tille do te vendosen me Supervizorin dhe do te aprovohen nga Punedhenesi.

1.16 Kantieri

Me perjashtim te rasteve kur ne Vizatimet e projektit specifikohet ndryshe, Kantieri sic percaktohet ne nen-klauzolen (f) (vii) te Klauzoles 1 te Kushteve te Pergjithshme ka kuptimin e nje trualli privat apo publike te caktuar qe sipas opionit te Supervizorit eshte i nevojshme apo praktik per zbatimin e Punimeve. Kontraktori nuk do ta perdore Kantierin per qellime te tjera nga ato te Kontrates.

Kontraktori, kur urdherohet, do te siguroje fotografi dhe do te rregjistroje me aprovimin e Supervizorit kushtet dhe kuotat e siperfaqeve te kantierit menjehere perpara se te futet atje per qellime ndertimi.

1.17 Kantieri per nevoja shtese

Ne rast se Kontraktori do te perdore rruge te perkoheshme apo akomodim shtese sipas Klauzoles 42(3) te Kushteve te Pergjithshme apo cdo siperfaqje

per hedhjen dhe vendosjen e materialeve shtese, ai duhet te kete pelqimin me shkrim te Pronarit dhe Zoteruesit apo te Autoritetit qe ka ne pronesi token ne te cilen e cila do te perdoret per qellimet e mesiperme. Ne te njejten kohe ai do t'i paraqese me shkrim Pronarit, Zoteruesit apo Autoritetit kushtet e ketyre siperfaqeve perpara se ai t'i perdorte.

Sipas Klauzoles 37 te Kushteve te Pergjithshme, Kontraktori do t'i lejoje Punedhenesit dhe Supervizorit, si edhe cdo personi te autorizuar prej tyre te perdore per qellimin e Kontrates cfaredo rruge te perkoheshme apo akomodim shtese te Kontraktorit. Per perdorimin e sa me siper, Punedhenesit nuk do t'i duhet te beje asnje kosto ekstra.

Ne rast se Kontraktori duke perdorur rrugete te perkoheshme te daljes apo akomodimet shtese qe atij i jane siguruar nga Punedhenesi per qellimin e kesaj Kontrate, toka ku ndodhet kjo rruge e perkoheshme daljeje apo ky akomodim shtese do te konsiderohet si pjese e Kantierit, ashtu sic perkufizohet ne nen-klauzolen (f) (vii) te Klauzoles 1 te Kushteve te Pergjithshme.

1.18 Toka ne dispozicion

Toka ne dispozicion falas te Kontraktorit do te jete ajo zone qe zihet nga vija e kalimit te rruges, kufizimet dhe drenazhet anesore si edhe cdo zone tjeter qe eshte perkoheshme e zene nga Punimet e Perhereshme.

1.19 Toka, Kompensimi dhe pagesat qe i takojne me te drejte kontraktorit

Punedhenesi do te siguroje te gjithë token qe do te perdoret apo do te zihet ne menyre te perhereshme nga Punimet.

Punedhenesi do te siguroje gjithashtu ne pergjithesi gjithë pjesen tjeter te tokes qe mund te kerkohet nga Kontraktori per ndertimin e Punimeve, duke perfshire edhe Punimet e Perkohshme. Por ne kete rast do te kerkohet miratimi i Supervizorit perpara se Kontraktori te hyje ne ate toke.

Ne te gjitha rastet, Kontraktori do t'i kerkohet te marre te gjitha masat me autoritetet lokale dhe/ose pronaret per te paguar koston e kompensimit ne emer te Punedhenesit. Per kete qellim, Kontraktori do te lidhet me autoritetet perkatese dhe do t'i njoftoje ne lidhje me fillimin e cfaredolloj punimi.

Punedhenesi do t'i rimburosoje Kontraktorit keto pagesa dhe te gjithë tokat e blera ne kete menyre do te jene prone e Punedhenesit.

Nje shume e parashikuar ne avance per kete blerje eshte perfshire ne oferte. Sipas marveshjes qe do te arrihet me Supervizorin dhe me te marre faturat, Kontraktori do t'i rimburosohet kostoja neto e kesaj blerjeje. Kostot e Kontraktorit ne berjen e ketij aranzhimi dhe kryerjen e pageses jane perfshire ne Shumen Specifike te Parashikuar ne Avance.

(Vijon)

UDHËTIM MES KONTRASTESH DHE RRUGËSH TË MBYLLURA

Nga ABDURAHIM ASHIKU

PËRSHKRIM

U rën dhe Kodrën e Kamzës e kaluam qetësisht. Ura është zgjeruar, po ashtu edhe rruga, duke këputur atë nyje që lidhte Tiranën me Veriun e që sa e sa herë i montonte njerëzit dhe makinat si me saldimit...

Edhe rruga që i bie mes për mes Kamzës është rregulluar në atë masë dhe ka marrë atë formë sa mund të thuash me plotë gojën "Rrugë e bukur"...

Më tej vjen Fushë – Kruja dhe autostrada (autostradë i thëncin) që i bie mes për mes fushës së Thumanës të ndarë e copëtuar si filxhani kur bie mbi gurë. Rruga, e trasuar në vitet tetëdhjetë dhe e asfaltuar në vitet nëntëdhjetë përbën arterin më të ngushtë të lidhjes me Veriun e më tej me Kosovën e Malin e Zi. Njëherë të çdo ditë (po tu referohesh kronikave lajm të parë në medien vizive) rrjedh gjak...

Iu shkëputëm "autostradës" për tu futur në një rrugë "fshati", gjithsesi të asfaltuar e për të dalë në rrugën e vjetër, ndo nja njëqind metra në veri të Kombinatit Kimiko – metalurgjik të Laçit siç quhej një herë e një kohë kur prodhohej superfosfat, acid sulfurik, bakër blister e ku ta di unë. Sot ai i qëndron pamjes si një fantazmë e shqyer nga vampiri i kohës...


Milotin e kalojmë anash. Nuk shoh asnjë ndryshim përveç ndonjë klubi apo godine tip alpin mes pishave. Të tjerat janë në atë vend që kanë qenë, të gërryerat e të shqyera duke filluar nga stacioni i trenit, tek magazinat e mëdha dhe më tej hekurudha. Nuk e kam fjalën për atë që lidhte Shkodrën e më tej edhe Malin e Zi dhe Evropën. E kam fjalën për atë rrugë të hekurit që në historinë e vet mbajti shina por nuk mbajti lokomotiva e trenat pasagjerësh e mallrash, për hekurudhën Milot – Rrëshen – Klos. Nuk e di në se këtë hekurudhë në të cilën derdhën djersë dhe gjak të rinj e të reja vullnetarë e profesionistë tunelesh e çarjesh shkëmbinjsh, e vranë vitet tetëdhjetë apo nëntëdhjetë të shekullit të kaluar, e vranë ato që e projektuan, që ndërjuan trase, ura, stacione trenash e shtruan shina nisur nga ëndrra e përcjelljes drejt Durrësit të mbi një milion tonëve në vit krom e minerale të tjerë metalorë e jo metalorë, lëndësh drusore e deri mollë kastrioti për eksport, apo e vranë ata që nuk kishin derdhë një pik djerse e gjaku në ndërtime e saj. Nuk di si ta them. Ose më mirë nuk dua që ta them...

E lash në krah të majtë "hekurudhën", e lash të shkojë drejt Rrëshenit jo si hekurudhë por si udhë drejt Kosovës, udhë që çuditërisht mbështetet mbi trasenë e saj. Një udhë e re mbi trase të vjetra...

RRUGËT E KUJTESËS

...Ura e Matit apo Ura e Zogut, siç mbeti pa u shuar për pesëdhjetë vjet emri i saj, urë që me gjithë rikonstrukcionin e para dy viteve përsëri mbetet me një hark mangët, hark që u hodh në erë gjatë fundit të Luftës së Dytë Botërore, përsëri ashtu është. Është me një hark mangët dhe me disa kuba betoni që kufizojnë hyrjen dhe daljen e saj për makinat e rënda. Nga sa pashë kalimthi aty mund të kalojnë vetëm vetura, biçikleta e motoçikleta; sigurisht edhe këmbësorë megjithëse asnjëherë prej këtyre nuk e hasa në vështrimin tim. Me sa duket, për kalimin e Matit dhe udhëtimin drejt Mirditës sot kalohet nga urat e tjera të gjëra e të forta poshtë Milotit.

Sa herë udhëtoj kësaj rruge nuk mund t'i shmangem kujtesës të udhëtimeve të vjetra, kohës kur ajo ishte e vetmja rrugë drejt Dibrës, një rrugë me dhembë të mprehtë gurësh dhe vende - vende shtruar me zhavorr lumi. Më kujtohet se nga Tirana në Rubik rruga ishte aq e gjatë sa një restorant në krah të djathtë të saj ku kishte gjellë por jo bukë



(asokohe buka ishte me triskë dhe duhej ta merrje me vete) ishte pika ku hanim drekën. Për një njeri që udhëton sot drejt Peshkopisë ajo që them i duket e sajuar, paradoksale. Mos nxitohet: kështu do ti duket tregimi i tij në të riu kur ai do të jetë në moshën time. Në qoftë se sot shkohet nga Tirana në Peshkopi për pesë orë asokohe për kaq kohë shkohej nga Tirana në Rubik...

Po i shmangem asaj rruge që sot lidh Tiranën, Fushë – Arrësin e Kuksin për pesë orë dhe nesër do të lidhë Tiranën me Kosovën për tre orë. Udhëtimi im i fundit asaj rruge ka qenë gushti i vitit 1964, asokohe student dhe bashkëpunëtor i gazetës "Zëri i Rinisë", udhëtim që do të më zbriste në honet e errëta të minierës së vjetër të bakrit, do të më ngjiste në Orosh e Fushë – Lugje për të kaluar një natë në çadrat e gjeologëve në Nënshajt, për të më zbritur dishenterisë së minierës së Kurbneshit, për të kaluar midis makinerive në punë të fabrikës së pasurimit të bakrit dhe së fundi për të bërë një reportazh për fabrikën e rafinimit të bakrit në ndërtime. Asokohe rruga e vjetër drejt Dibrës ishte mbytur nga liqeni i Ulzës...

RRUGA E DRITËS

U ndava nga traseja e "rrugës mbi rrugë" që donë të kapë Kosovën. E mirëpritur nga njerëzit e thjeshtë, e përfolur nga politika e cila çdo rrugë që hapet nuk mungon ta kthejë nga porta e shtëpisë së vet, rruga po ecën duke çarë lugina e tunele...

Tani po eci Rrugës së Dritës. Kështu është quajtur, kështu do ta quaj edhe unë. Në kthesën e parë, sapo kalon urën, syri më kap një pamje që mund ta fiksojë me një të shkrepur aparati. Nuk e bëra. Dhe, megjithëse e di se ajo pamje nuk do të ndryshojë për shumë kohë, nuk do ta bëj.

Djathtas në mes të fushës në vitet nëntëdhjetë një ndërtesë dykatëshe, me shesh parkimi, me një restorant plot dritë e plot asortimente të freskëta nuk të linte të bësh përpara pa pirë një kafe në mëngjes ose pa ngrënë një drekë të shijshme. Lokali tash është shndërruar në gërmadhë, në fole kukumjaçkash. E shndërroi viti i mbrapshtë nëntëdhjetë e shtatë. Për kazmën që i gërreu themelet kam dëgjuar ca gjëra kalimthi...

Majtas, rrëzë një kodre të butë që mban në shpatulla një pyll të dendur dushku është ngritur një ndërtesë e re. E bukur është, me çati në stil alpin e dritare të mëdha. Më thanë se është ndërtime dy vjetër e fundit...

...Një tunel i vogël në të dalë të të cilit ka qenë një pllakë mermeri mbi të cilin ishte shkruar emri i një njeriu që aty kishite humbur pranverat e tij. Më tej Shkopeti po me pamjen e vjetër, rrethuar nga shkëmbje që të këpusin qafën në qoftë se donë tu shohësh majat, me qytezën e trishtë, stacionin e tensionit të lartë në portën e të cilit ende qëndron një datë, viti 1962 kur dha për herë të parë dritë. Më tej diga e betonit e kapur krah për krah me të dy anët e shkëmbinjve të fortë dhe në këmbë të saj uji i kaltër, i pastër dhe i tejdukshëm si kristal që pasi ka dhënë dritë merr rrugën e mërztishme drejt...

Këtu mendimi më fluturoi larg, jo pak por rreth një mijë kilometra. Mu kujtua kanali i madh që përshkon tej e tej Thivën, i mbushur me ujë po kaq sa është i mbushur Mati këtu, me ujë që e merr nga një liqen artificial mbi lumin Monro për ta përcjellë në afro dyqind kilometra gjarpërim në Athinë, sigurisht pasi ka kaluar në impiantet e pastrimit dhe dezinfektimit. U ndala dhe mendova: A nuk do të ishte gjë e mirë që prej këtu, atje ku shuhet shkuma që krijojnë turbinat të hapej një trase e mbi të nëpërmjet një kanali të betonuar apo tubave të mëdhenj uji të "përmbytët" çezmat në tërë hapësirën që nga Milotit, Laçi, Fushë Kruja, Vora, Shijaku, Durrësi e deri në Kavajë? Pyeta dhe pyes, pa marrë përgjigje. Pyes përsëri, me shpresë që një ditë, në mos unë, të tjerët, të pinë ujë dhe të bëjnë dush nga uji i Shkopetit. Ka ardhur koha ta shohim botën dhe jo ajo të na shohë ne "anës ujit i pa larë"...

... Mikrobusi përshkon, si peri gjilpërën, tunelin e Shkopetit, ashtu siç ka qenë, "pranë dritës i pa parë", për të na dhënë atë lloj kënaqësie që ta jep uji i liqenit dhe gjelbërimi, që i reflektuar në të e mbi të, ia ka ndryshuar ngjyrën nga e kaltra në të blertë.

Para kthesës që të fut në luginën që të çon në Ulzë, gjithnjë kthej kokën djathtas dhe vështrimi më ngulet në një fshat të vogël, në Madhesh, në një kanal sipër tij e në një kullë mbi një majë kodërze. Atje, në vitin 1974, kur isha korrespondent i ATHSH-së pata bërë një kronikë për kanalin dhe qesh shtruar në një sofër kulle të moçme me një pjatë me hudhra të njoma, gjizë të bardhë si gëlqere, peshk liqeni e raki të zierë dy herë nga rrushi me erë që rrethonte shtëpinë. Aty mësova edhe një histori jo shumë të largët në kohë. Afro njëzet e pesë vjet më parë, kur ende nuk ishte trasuar rruga dhe ndërtime e hidrocentralit të Ulzës bënin kilometra të tëra

rruge nga Rrësheni, banorët e fshatit jetonin në një komunitet gati mesjetar. Kur rrallë – rrallë shkonin në Burrel për Pazar ata, në shkëmbim të mallrave ofroni para që datonin që nga koha e turkut, koha e Zogut e deri në kohën e pushtimit. Dhe kur shitësit u thoshin se "këto para nuk shkojnë" ata shprehnin habinë dhe deklaronin "Nuk ka gjë, shkojnë në fshatin tim". Hapja e rrugës së Dritës do të sillte për ta jo vetëm dritë elektrike...

...Rruga nuk hynë në Ulzë, merr djathtas mbi një urë në ballë të së cilës, mbi një mur rruge ende një parullë (nga parullat e shumta të politizuara të kohës së shkuar) nuk është shuar. "Të jetojmë me situatat, të realizojmë detyrat" shkruhet si për të na thënë se duhet të shtrëngojmë rripin, të rrimë pa drita e pa ujë, të kërkojmë e mos gjejmë punë...veçse tej kufijve të dheut të të parëve.

Pamja që të mbërthen sapo ngjitesh pas atyre kthesave të forta në kodër të Ulzës është trishtuese. "Gjethen e hardhisë" që i jep formën e vet pasqyrës së ujit duket sikur e ka mbërthyer peronospora dhe oidiumi, vrugi dhe hiri, duke i shtrirë hifet e veta thellë qelizave e duke e tharë. Në një kthesë shtypa butonin dhe fiksova një pamje. E fiksova në memorien e kompjuterit, sa herë e hap, më trishton. Ma do mendja se të njëjtin trishtim do të përjetoja edhe sikur të kisha fiksova pamjet e liqenit të Fierzës e Komanit. E kaluara në shtatëmbëdhjetë vjet qeverisje bëri pesë hidrocentrale. E sotmja, në po të njëjtën hapësirë kohore nuk ka bërë asnjë. Në dialektikën ekonomike ka një aksiomë: një rend ekonomik shoqëror fiton mbi rendin para ardhës duke e përcjellë atë në "kujtesë të historisë" kur krijon vlera më të mëdha, mirëqenie më të madhe, liri për të gjithë. A e ka mundur "demokracia shqiptare" "diktaturën shqiptare". Unë nuk munda vë dorën në zjarr për t'i dhënë përgjigje pohuese.

RRUGË TË LASHTA

Lugina e Matit është e zhytur në gjelbërimin e misrit dhe të jonxhës. Burimin e tij do ta shohësh nga fundi i luginës, pasi kalon Klosin, tek ndalesh, pushon, pi një kafe dhe sipas kohës ha ndonjë paçe të ngrohtë ose mish të pjekur viçi "viologjiko" siç do të shënonin grekët supermarketeve. Lokalet freskohen me ujin e Matit, jo të atij që rrjedh shtratit të lashtë por të atij që rrjedh në konstruksione betoni që diku mbështeten në tokë e diku tjetër mbështeten

mbi kërraba të betonta. Kanali ka aq ujë sa t'i japë luginës blerim dhe lokaleve e lavazheve ujë të bollshëm jo të pijshëm. Matjanët nuk i vunë minat kanalit të tyre, i dhanë dhe i marrin jetë...

...Tek kthesa, para se të marrësh të përpjetën drejt Qafës së Buallit, djathtas, ka një urë. Dikur, kur ishte në konstruksione metali (tani është e betonit), kam marrë rrugën tej asaj ure. Ka qenë tetori i vitit 1964. Diplomati dhe publicisti i njohur Javer Malo i cili ato ditë kishte qenë në Dibër e më vonë do të botonte në Zërin e Popullit një reportazh të gjatë që do të zinte tre numra të gazetës, i bëri shenjë shoferit që të kalonte mbi urë. Gazi mori të përpjetën e Planit të Bardhë duke kërcyer mbi gurët e rrugës, me të katër rrotat aktive, me një shpejtësi që nuk i kalonte të pesëmbëdhjetë kilometrat në orë. Udhëtonim nëpër një rrugë të vjetër, një rrugë që do të na nxirrte në Bizë e Shëngjergj, në atë hapësirë bjeshkësh madhështore, mes fshatrash të harruara. Një herë në jetë do të udhëtoja asaj rrugë të mbyllur. Pse ishte mbyllur do ta mësoja dhjetë vjet më vonë, kur punoja si korrespondent i ATSH - së për Dibër dhe Matin. Në analizat vjetore që bënim, një kapitull u kushtojë objekteve të " kohës së veçantë ". Në atë zonë ishin instaluar dhe ishin në gatishmëri të plotë të gjitha objektet mediatike të pushtetit, përfshirë edhe strehimet për udhëheqjen e lartë. Nuk e di pse sot, kur kohët kanë ndryshuar e objektet janë shkatërruar nuk është zgjuar kjo rrugë. Unë nuk kam dëgjuar asgjë për të, përveçse në një variant të ri të Rrugës së Arbrit.

Po ku është Rruga e Arbrit ? Ku del dhe ku hyn ajo këtyre maleve dhe luginave. Një miku im, Bujar Karoshi, më dërgoi një botim me referate e kumtesa për Rrugën e Arbrit mbajtur në një sesion të veçantë nga intelektualë dibranë, të kësaj dhe të asaj ane të kufirit shqiptaro - shqiptar. Hedh sytë të gjej ku është Ura e Vashës. Diku është fshehur në kalim të Matit. Ngjitem lart, Qafës së Buallit, dhe kërkoj trasenë dhe pikën ku do të nisë tuneli për të dalë në Bulqizë. Por më shumë kërkoj në kujtesë. Ngjitem mbi Qafë Shkallë, atje ku është ngritur një lapidar në kujtim të Zonja Curres dhe tres vështrimin në kërkim të rrugëve të vjetra të dibranëve drejt Tiranës, kërkoj hanet, atë të Rrasës së Allushit dhe të Lleshit në Klos Katund që ende ekzistojnë në sajë të mbrojtjes që iu bë nga shteti duke i cilësuar si monumente kulture, kërkoj Qafë Murizën, Xibër Murizën, Xibër Hanen, Gurin e Bardhë, mullinjët dhe burimet e mëdha të ujit për tu ndalur në Shkallë të Tujanit. E frikshme më vjen në kujtesë Shkalla e Tujanit. Më kishte hyrë në palcë frika e saj falë tregimeve të babait dhe të kafsharëve që përcillnin deri në vitet pesëdhjetë drithë e bulmet në këmbim të kripës e ndonjë rrobe të përdorur. Shkalla e Tujanit ishte aq e ngushtë, aq rrëshqitëse sa kishte marrë me dhjetëra jetë kafshësh me ngarkesë, madje edhe njerëzish. Rruga gjashtë ditore, tre në të vajtur dhe tre në të ardhur, ishte një ankh për ata që udhëtonin dhe për ata që prisnin fundin e gëzuar të tij. Unë Shkallës së Tujanit kam kaluar në vitin 1962. Atëherë ajo ishte çarë dhe nëpër të kalonin makinat. Asaj qafe, atyre maleve do të kalojnë një ditë makinat, në dy korsi vajtje dhe në dy korsi ardhjeje, do të hapen tunele për të dalë në Klos e në Bulqizë. Ajo rrugë thonë se do ta afrojë Sofjen e Bullgarisë më afër Adriatikut se sa Detit të Zi. Për mos me folur pastaj për Tetovën, Gostivarin, Kosovën e më gjerë. Në Dibër, në më pak se tetëdhjetë kilometra do të shkohet për një orë. Dibra me Tiranën do të jetë aq larg sa është Athina me Korinthin...

Do të desha ta jetoja atë ditë ashtu siç do të deshën ta jetonin dibranët, tetovarët, kosovarët. Është arteri më jetik i shqiptarëve të ndarë pas arterit të rrugës Durrës - Morinë. Nuk e di në se e kuptojnë këtë gjë politikanët tanë, jo në fushata zgjedhesh ku deklarata dhe përrurimet e fillimit të punimeve nuk kanë munguar, por në plane perspektive, me kohë e afate të caktuara, me investime të shtetit apo me koncesione. Rrugët



Kujtim nga vendlindja

drejt Dibërës ka ardhur koha të hapen në të gjithë hapësirën e vet. Boll janë mbyllur...

Në Tiranë është " Rruga e Kavajës " që të çon në Kavajë, është " Rruga e Durrësit " që të çon në Durrës, është " Rruga e Elbasanit " që të çon në Elbasan...Në Tiranë ka një rrugë që quhet " Rruga e Dibërës " që nuk të çon në Dibër, në qoftë se nuk do të kthehesh në mesjetë, pas karvanëve me kuaj e mushka...

RRUGË TË MBYLLURA

Në Milot takuam trasenë e hekurudhës Milot - Rrëshen - Klos shinavjedhur. Luginës së Matit kaluam bri trasës së shtruar me zhavorr, anash urash të mëdha prej betoni, madje edhe nën harkun e një rës prej tyre. Dikur, në vitet '90-të kam shkruar se i u zhveshën stacionet e trenave në Burrel e në Klos, si u shkulën tullat dhe si u nxorën hekurat nga betonet e forta. Sot, në syrin e një udhëtari të zakonshëm vetëm urat e mëdha dhe disa konstruksione të larta betoni në " stacionin e fundit " janë dëshmitarë se dikur këtu është menduar dhe punuar për një rrugë të hekurat.

...Kur ngjitesh në Klos Katund nuk mund të rrih pa e zbritur vështrimin poshtë, atje ku në një shesh dikur u ngrit një impiant i madh për pasurimin e kromit. Nuk mund të rrih pa e zgjatur shikimin atje ku dy tunele kishin nisur të çajnë malin drejt nivelit të pestë të minierës së kromit që aso kohe mban-te emrin e Todo Manços, kryeinxhinierit të palodhur të minierës së Bulqizës. Atëherë thuhej se tunelet, nga sasia e ujit që do të merrnin dhe përcillnin nëpër barkun e tyre do të jepnin për bujqësinë matjane vlera që barazoheshin me ato të transportit të kromit. Ti i sheh por ato nuk të shohin. I qorroj koha ashtu siç qorroi edhe Rampën mbi Qafën e Buallit funksioni i së cilës ishte të zbriste në nivelin e pestë kamionet e rëndë.

Thonë se minerali i kromit është rritur me disa herë në vlerë dhe është shumë i kërkuar në botën e jashtme. Shkruhet se në Bulqizë, firma që ka marrë minierën me koncesion, nuk po bën asnjë investim kapital dhe se mendjen e ka vetëm tek shfrytëzimi i mineralit që në thellësi të nivelit të dymbëdhjetë e katërmëdhjetë është në përqindjet e mineralit të pasuruar. Dokumentohet nëpërmjet shtypit dhe radiotelevizionit se si pasojë e shfrytëzimit barbar që po i bëhet minierës së kromit dhe i masave të pakta dita ditës humbasin jetë njerëzish. Nuk jam shumë i informuar për shkak të largësisë ku jetoj por më duket se mbi kromin shqiptar, këtë pasuri unike që dikur e radhiste Shqipërinë në vend të tretë në botë për nxjerrjen e mineralit në tërësi dhe në vendin e parë në botë për nxjerrjen e mineralit të kromit për frymë të popullsisë, është vënë kryq mbi perspektivën, janë mbyllur të gjitha rrugët dhe shtigjet, ato rrugë e shtigje që gjeologët tanë bënë që të lindë Batra, Krasta dhe Thekra e Martaneshit, Tërnova, Selishta e Cëruja...

RRUGË TË NËMURA

Kush ka udhëtuar drejt Peshkopisë vite më parë (por edhe sot) nuk mund të mos ndjejë një ngushtim supesh, sikur do të kalojë nëpër vrimën e gjilpërës, sa herë kalon Urën e Qytetit dhe i ngjitet të përpjetës së Peladhisë. Unë të paktën kështu e ndjej veten sa herë udhëtoj. Kështu e ndjeva edhe në shtator kur e desh puna të shkoja në vendlindje.

Ndjenja lidhet me një fakt, me një dëshmi dhe një kujtim të para më se tri dekadave...

... Në Peshkopi mbahej një aktiv kulturë, aktiv i drejtuar nga partia në pushtet. I deleguar i Komitetit Qendror dhe i Këshillit të Ministrave ishte caktuar Mehmet Shehu. Nuk mund të them me saktësi se në se ishte maj apo qershor i vitit 1973. Një gjë mund të them me saktësi. Nga qeveria shqiptare ishte planifikuar që edhe rruga që lidhte Bulqizën me Peshkopinë të asfaltohej. Punimet, në rrugë të gjerë dy kalimëshe, sapo kishin kaluar Urën e Qytetit dhe i ishin afruar të përpjetës së Peladhisë, atje ku ishte ngritur një impiant asfaltobetoni. Aty u ndal Mehmet Shehu me suitën që e shoqëronte. Pa mbrapa, pa përpara dhe u nxi në fytyrë siç dinte të nxihej ai kur merrte inat. Bëri me dorë përpara dhe deklaroi si në një ekzekutim: " Dibërë nuk i duhet rruga dy kalimëshe. Të asfaltohet vetëm me një kalim... ". Kështu u tha dhe kështu u bë...

Kështu është edhe sot rruga por më ngjan edhe mentaliteti. Nga ata copa rrugësh që po asfaltoheshin (tek ura e Topojanit) nuk pashë buldozerë që të hanin shpatet e të zgjeronin rrugën por vetëm makina asfaltobetoni që hidhnin zift e zhavorr mbi rrugën ekzistuese.

Duket se rruga drejt këtij qyteti në Verilindje të Shqipërisë, rruga drejt Dibërës, qendrës gjeografike shqiptare është e nëmur. Ndoshta gaboje por faktet në këtë konkluzion më sjellin. Bëjeni ndryshe dhe unë do të ngrihem në këmbë e do të përkulem deri përdhe në shenjë pendimi.

QYTETI I ËNDRRAVE TË MIJA

Peshkopia më befasoi me ndryshimet e dy viteve të fundit.

Në pikën dominuese të pamjes së dy krahëve të saj, krahut të vjetër me përroin e llixhat thellë tij, dhe krahut të ri me ndërtime të dekadave të fundit, djathtas muzeut historik materialet e të cilit më thanë se janë magazinuar në një magazinë të vjetër plot lagështirë, bëjnë përpjetë konstruksionet ndërtime të dy minareve të xhamisë së re të qytetit, ndo nja njëqind metra në vijë ajrore nga xhamia e vjetër.

Sheshi para ish komitetit të partisë që tashti është bërë prefektura e qarkut, shesh i cili qe menduar që të mbajë një përmendore kushtuar historisë dibrane ishte " bunkerizuar " nga një ndërtim i

rëndomtë duke i mohuar qytetit pamjen më të bukur që paraqitet sapo merr kthesën e Llasenit dhe sheh si në pëllëmbë të dorës Peshkopinë.

Për të tjerat nuk po shkruaj. Nuk po flas as për pallatin e sportit që është kthyer në gërmadhë dhe qëndron në këmbë falë skeleteve të forta të betonit, as për lulishtet e bukura të Agush Selishtës (vërtet a e ka bërë qytetar nderi Peshkopia Agushin e madh të gjelbërimit dhe lulëzimit të qytetit ?) që janë betonuar. Po iki i mërzitur edhe pse mërzitinë disi ma uli " Bulevardi i Blireve " ku ende shëtitet mbrëmjeve pa u shqetësuar nga makinat dhe mjetet e tjera të motorizuara dhe ku mund të takosh ndonjë të njohur e mik të vjetër.

RRËNJË TË VJETRA

E lash Peshkopinë pas shpatullave me gjithë kujtimet e një jete të gjatë aktive, me gjithë pasionin dhe dashurinë që kam për të dhe mora rrugën drejt fshatit të lindjes, Zdojanit, nja pesë kilometra larg qytetit. Desha të udhëtoja në këmbë për të kujtuar vitet pesëdhjetë kur bëja dhjetë kilometra rrugë në ditë për të vazhduar shkollën shtatëvjeçare. Desha të ndalesha rrugës e të mblidhja thana e manaferra që në ato vite ishin gardh nga të dy anët e rrugës dhe na shuanin urinë e kohës. Desha...

Lere se çfarë desha e dua unë...

Një mikrobus më mori në barkun e vet dhe unë nuk mund të bëja gjë tjetër veçse të kundroja rrugën herë majtas e herë djathtas. Të shikoja në Rashnapojë një kopsht të bukur me mollë në përmasat mbjellëse të kohës, degë varura nga mollët starking aq të dashura dhe aq të pranishme në plantacionet e mëdhenj të dikurshëm në Kastriot, Sllovë, Zdojan e gjetkë. Mu bë qejfi kur pashë atë kopsht. I thashë vetes se në tokën dibrane nuk janë shkukur rrënjët e një periudhe nga më të arriat në historinë e zhvillimit bujqësor të saj.

Djathtas nuk mund të rrija pa kërkuar vijën dhe ujin në vijën e malit. Të parën e gjeta mes " shpendrash e ferrash " kurse të dytin nuk e gjeta kurrkund. Uji i malit nuk zbriste më poshtë se Rashnapoja. E pinte " kuçedra ". Jo kuçedra e përrallës por ajo e vetëgjyqësisë...

...Dibra, edhe pse kanalet i janë tharë nuk lë pëllëmbë toke pa mbjellë. Një rrënjë kjo e dashurisë për tokën, për atë që e ka mbajtur gjallë ndër shekuj...

...Në Zdojan mbërrita pak mbas mesdite. Shkoja për të qenë i pranishëm në martesën e mbesës sime, Drionës së bukur me Blerimin emigrant në Rethimno të Kretës. Si më i madhi i pesë vëllezërve dhe dy motrave zura vendin tim në konak...

...Në Dibër ka qenë zakoni që në rastet dasmash nuk bëhen ftesa " për vizitë ". Ai që të do dhe të nderon, më të marrë vesh për gëzimin tënd, vjen të të bëjë një " hajrli ", të pijë kafën e gëzimit...

...Në Dibër është përsëri zakoni i vizitës tradicionale " për hajrli " e për " një kafe të ëmbël ". Në tre ditë, këtë rrënjë të shëndetshme të zakoneve tona, e përjetova me një gëzim të thellë në shpirt. Takova në ato vizita njerëz që më ngjallën kujtime të hershme, bashkënxënës në klasën e parë të shkollës fillore, njerëz që isha rritur me ta duke bredhur atyre kodrave të bukura e duke u larë në ujët e Drinit që i qëndron katundit si një kurorë lulësh të kaltra.

* * *

Në kthim nuk mund të rrija pa u ndalë në hyrje të Shupenzës. Një miku im i vjetër, në kabinën e "skodës" të të cilit kisha udhëtuar e reportazhet e tij për vendet dhe njerëzit i kisha redaktuar, kishte gjetur telefonin tim në Athinë e më kishte përcjellë gëzim dhe mall. A mund të rrija pa e takuar Kujtim Gjelleshin ?

... Udhëtova një ditë shtatori drejt Dibërës...

... Bëra udhë mes " Kontrastesh dhe rrugësh të mbyllura "...

Shtator 2007
E-mail: a_ashiku@yahoo.gr
00306938103747.

Traktimi mitologjik i legjendës shqiptare mbi ylberin*

Nga AGRON TUFA

Brezi (në disa zona të Dibrës së Epërme dhe Lumës quhet *shoka*), paraqet në vetvete një element të pandarë të kostumit nacional në një shumicë popujsh. Duke lënë mënjanë anën estetike e etnografike, ne do t'i kushtojmë vëmendje vetëm traktimit mitologjik të përdorimit të tij të domosdoshëm në disa krahina të Shqipërisë së Veriut.

Në Dibrën Veriore dhe në Lumë mund të dëgjosh një legjendë të tillë arkaike: "Njëherë ndrikulla shkoi mysafirë të kumara i vet. I ndodhur vetëpërpvetëm me të në shtëpi, kumarës i ra në kokë ngasja tunduese e mishit, iu err arsyeja dhe u lëshua mbi ndrikullën që të shkruhej epshin. Ajo, nga ana e saj, duke ndjerë tmerin e këtij incesti, doli me vrap nga shtëpia, e ndjekur nga kumara, kaptoi korije e përroska, gjersa më në fund kumara e arrit majo një kodre, ku e çnjerëzoi. Gjatë kohës së mëkatimit, shokën e saj të zgjidhur e rrëmbeu era duke e kthyer në ylber, si shenjë të përjetshme të këtij incesti". Në këto krahina edhe sot e kësaj dite, kur shohin ylberin, thonë: brezi (shoka) i ndrikullës.

Duhet rrahur të analizojmë raportet e ndërsjella midis dy mitologjemeve – ylberit dhe shokës – ne do të veçojmë dy plane themelore në studimin e legjendës. I pari – "sipërfaqësor", që cek motivin fundamental të incestit dhe i dyti – "vertikal", i cili na shpie në arkaikën e hershme dhe që na lejon të merrmi me kërkimet mitologjike, dhe gjithashtu, me mitologjinë krahasuese.

Sipas mendjes popullore shqiptare, mëkati ndrikull-kumar konsiderohet edhe më i rëndë se motër-vëlla. E mbërritur deri në ditët tona, legjenda na përcjell një mesazh të natyrës didaktike. Subjekti i saj është i grishur t'i kumtoje receptuesit – para së gjithash – që "incesti është punë e keqe".

Duke njohur tekstat e baladave të lashta shqiptare, arrijmë në përfundimin se incesti, për nga forca fatale, barabitet me gjëmat natyrore, p.sh., me përmbytjen e madhe. Në një shumicë të tillë tekstesh mund të gjesh elemente peripeçish të tilla: forcat e natyrës p-jesëmarrin në marrëdhëniet e heronjve dhe përipiqen gjithëfarësor të pengojnë incestin e pavetëdijshëm (kur motra dhe vëllai, pa ditur gjë për lidhjet e tyre të gjakut, vendosin të hyjnë në mëkat, atëherë lind një tufë zogjsh fatidikë, bie shi gjaku etj.). në Eposin e Kreshnikëve të shqiptarëve të veriut, njërit prej heronjve qëndrorë i ofrojnë të zgjedhë për nuse më të bukurën nga tridhjetë perritë e krahinës. Porse ai, i fyer, e hedh poshtë këtë propozim me një ligjëratë të tillë të pezmatuar:

"Zoti ju vraftë, more agët e Jutbinës!
Po ku a ndie n'mjet tokës e t'qiellës
Se muer vllau motrën e vet?
QI tanë bijat e Krahinës ku janë,
Tanë si motra qi po m'duken!"

Lind pyetja: përse *ndër shqiptarë*, ndryshe nga një shumicë popujsh, përfshi dhe ata të gadishulitit ballkanik, incesti mbetet një ndër tabutë kryesore? Këtu kemi të bëjmë, ndofta, së pari, me kultivimin e institucionit të kumarisë (probatinisë) në rrang shenjtë dhe së dyti, me kundrimin e martesës si akt simbolik i "pushtimit të nuses" përmes "fitores mbi babanë apo vëllanë e madh". Në rastin e parë, ashiqare, ia vlen të kthehemi në kohërat e shthurjes së komunitetit primitiv, kur ndodh refuzimi i ngadaltë nga poligamia dhe, si alternativë e mundshme e martesës poligame lind "kumaria", madje, dhe ndërmjet mashkullit e femrës. Në rastin e dytë jemi të shtrënguar ta kundrojmë arketipin e dasmës si fakt jo vetëm jetësor, por edhe shpirtëror dhe mistik në jetën e njeriut. Material të begatë e origjinal në këtë drejtim na jep folklori – jo vetëm

në format e riteve dhe bestytive, por edhe në trajtën e eposeve e përrallave që kanë mbërritur gjer tek ne. për ilustrim, vlen të përmendim studimin antologjik të Vladimir Propp-it, "Morfologjia e përrallës", në të cilin rrëfëhet për variante të ndryshme të subjektit të përrallës. Për shembull, për të marrë princshën për grua, heroi i përrallës është i detyruar të mundë Gjarpër Gorinicin, Koshcejen apo ndonjë tjetër përbindësh, domethënë, sipas Propit, të ashtuquajturin "dëmtar" që, si rregull, na del se është jo kush tjetër pos babait (apo një tjetër njeriu të afërt) të princshës. Përralla, pa dyshim, shfaqet jo vetëm pasqyrim i arkaikës mentale të popullit, por edhe vetë sikur i i mponon njeriut të lashtë ato apo të tjera etalone etike. Këtu vetvetiu të shkon mendja te konkluzioni frojdist e të gjeturit burrë për vete me funksionin e babait për gruan (apo nusen) si dhe për shkëmbimin e njërit me tjetrin. Këto shpjegime të tabusë incestuale na duken nga më bindëset, përdërisa, njeriu i vjetër zor të ketë marrë erë nga nga kodet gjenetike dhe ashiqare, pak e ka vuarë mendjen mbi faktin se nga flligështia e përhershme e gjakut, herët apo vonë, mund të lindin në familje monstra. Megjithatë, vetë mendi-



mi se vëllai që martohet me motrën e vet ka për borxh (qoftë edhe në kuptimin simbolik, qoftë edhe në nivelin e pavetëdijës) të "triumfojë" mbi babain e tij, domethënë, ta zëvendësojë atë në gjithçka ka të bëjë me vajzën, duke kryer në këtë mënyrë *atëvrasje* simbolike, ky mendim duket e ka trembur njeriun dhe ka shkuar në të kundërt me normat e tij etiko-morale. Kësaj, mbase pikërisht për këtë, martesat ndrikull-kumarë është konsideruar si mëkat edhe më i madh se sa martesat ndërmjet të afërmeve me lidhje gjaku.

I rikthehemi ylberit dhe shokës. Në zona të ndryshme të Shqipërisë së veriut, ylberit ka disa emërtime: "brezi i Shën Mërisë së Virgjër", "brezi i Diellit", "brezi i Zoodiakut" (P. Bogdani), "brezi i Perëndisë", "Brezi i Havës", "brezi i Muahmetit" etj. pra, vlen të theksohet se ylberit shpesh merrej si njëfarë dërgese nga sipër, si një shenjë hyjnore. Në të tilla rrethana, legjendën për ylberin ia vlen ta kqyrim si subjekt të ngarkuar me didaktikë të vonë religjioze, ku femra iu kundërvu mëkatit seksual, ndonëse, e nënshtruar me përdhunë, konsiderohet tashmë si martire dhe në shenjë të pastërtisë dhe shenjtërisë së vuajtjeve të saj, në qiell shfaqet shenja hyjnore e dërguar nga lart.

Nëse flasim për interpretim arkaik të kësaj legjende, duhet të kujtojmë atë çka më sipër përmendëm shkarazi. Dhe pikërisht atë që, incestin e pavetëdijshëm e pengonin vetë elementët e natyrës, duke i

shpërqendruar pjesëmarrësit potencialë të incestit (po, dhe duke i gjymtuar me gjithëfarë stihish. Përveç gjëmave të ndryshme, enumërohet edhe përmbytja e madhe, forca tragjike e së cilës barabitet me gjëmën e mëkatit, siç jo rastësisht, do ta shohim më poshtë.

Siç dihet, në shumicën e popujve ekziston përfytyrimi i dasmës së përjetshme mes qiellit dhe tokës, madje, si rregull, toka paraqitet në rolin e femrës, kurse qielli – në rolin e mashkullit (egjiptianët dhe disa popuj të tjerë kanë të kundërtën). Interesante është se dasma e qiellit me tokën ka zanafillë incestuale (toka së pari lind qiellin - Gea pjell Uranin – kurse më pas e merr për burrë), ndonëse në këtë stad zhvillimi të kozmogonisë, incesti nuk qortohet, por përpkundrazit, merret si një gjë krejt e natyrshme dhe e domosdoshme (krahasojeni me subjektet e mëvonshme, kur lulëzon motivi i incestit, p.sh., me mitin e Edipit...). Mjeti më i drejt-përdrejtë i bashkimit të tokës me qiellin paraqitet shiu, vaditësi, mëkuesi dhe plënuesi i barkut bujar të mëmë-tokës. Rrjedhimisht, përmbytja – vepron në llojin e vet si njëfarë katarsis, që pastron dhe në të njëjtën kohë ushqen tokën, simbolokisht muand ta quajmë veçse si një akt seksual të qiellit me tokën (se përmbytja s'është gjë tjetër veçse rrjedhojë rrebeshesh të bollshme). Sipas dëshmimeve të A. Afanasievit ("Pikëpamjet poetike të sllavëve në natyrë", V.1, fq. 362), "një legjendë bullgare pohon se para përmbytjes biblike, nuk ka patur ylber; po kur toka u tha dhe Noeja i solli Zotit fli, atëherë Perëndia i premti atij se përmbytje nuk do të ketë gjer në ardhjen e dytë të Krishtit, dhe si dëshmi, na dhuroi ylberin e tha: "Përdërisa të shndrijet në qiej ylberi – nuk keni pse të frikësoheni, po kur ylberi të zhduket – kjo ka me qenë shenjë se dita e gjykimit të tmerrshëm po afrohet...". Në përmbledhjet me dorëshkrime të vjetra apokrifike, thuhet "Ylberin e krijoi Zoti pas përmbytjes" (Përmbledhja Apokrifike e vitit 1531)... "pas përmbytjes, Zoti vuiri një hark në qiell si shenjë dalluese për përmbytjen e dytë që do të ndodhë"... Ky çast solemn lidhet me "dhjatën" që Zoti Jehova i dha Noesë. Ja se si interpretohet kjo "dhjatë" në enciklopedinë "Mitet e popujve të botës": "Zoti fillon ndëshkimin e tokës për shkak të mëkateve të njeriut me rrotullimin e rregullt të stinëve të vitit përpara: "Në të gjitha ditët e tokës, mbjellja lide korra, zhegu e thëllimi, dimri dhe vera, dita dhe nata nuk do të ndalen" (8,22). Noeja qëndron para Jehovait si stërgjysh i njerëzimit të ardhshëm dhe si Adam i ri që merr në fillim po të tilla bekime: "shtohuni dhe shumohuni, dhe mbushni tokën!" (9,11). (22,24). Dhe kështu, para nesh na del njëfarë rrethi i premtuar, këtu vetvetiu mendja të shkon te analogjia e formës harkore të ylberit. Sidoqoftë, harku është veçse pjesa e dukshme e ylberit. A. Afanasievi, në veprën e njohur "Pikëpamja poetike e sllavëve në natyrë", shkruan: "Forma gjysmërrethore e ylberit të çon ndërmend, dashje padashje një unazë gjigande që përfaqë tokën. Në Bavari atë e quajnë *himelring, sonnenring*..., madje disa besojnë që në asnjë mënyrë ajo nuk duhet quajtur me emrin e vet, porse vetëm nëpërmjet eufemizmave "Unaza qiellore", që të mos biesh në pushtetin e djallit..." (1,358). Kështu pra, ç'do të thotë "unazë"? Unaza është shprehje e qarkullimit të natyrës dhe në të njëjtën kohë, unaza është paraqitja e stërlashtë simbolike e kohës. Kujtojmë se indianët dhe keltët e lashtë me "gjarprin që kafshon bishtin e tij" – se pikërisht me vizatime të tilla, si rregull, janë gdhendur sarkofagët dhe përmendoret e varreve të lashta. Meqë ra fjala, ekziston në një shumicë popujsh emërtimi "gjarpër i ylbertë". "Në trajtën e një gjarpri të ylbertë lidhen përfytyrimet për frymën e ujrave, gjarprin – monstër, kristalin magjik

(në të cilin pasqyrohet spektri ylberor), i cili shfrytëzohet nga magistricat; ylberi asocionon me shiun dhe magjinë e plleshmërisë". (Mitologjia. Fjalori i madh enciklopedik nën redaktimin e E. M. Meletinskij, Moskë, 1998, f.462). nëse ylberi është shprehje e qarkullimit në natyrë, atëherë, si dhe në rrjedhën e kohës, në ylber ka një gjysmërreth të ndritshëm, mbitorësor, të qiellit, apo, nëse e doni, hyjnor, sikundër pjesa tjetër është e errët, nëntokësore, e vdekshe.

Këtu është krejt me vend të kujtojmë për brezin (shokën) si për gjendjen e parë mitike të ylberit. Në shumicën e popujve, barku identifikohet me vetë jetën (te indianët e vjetër barku konsiderohet si rezervuar i energjive "Agni": "Në letërsinë postindiane agni konsiderohet gjithashtu në aspektin fiziologjik si element i organizimit të gjallë – zjarri i "barkut" ("audaria"). (Induizëm. Xhajnizëm. Sikhizëm: fjalor. Moskë, 1996): Ndër sllavë vetë fjala "bark" ka patur kuptimin zanafillor "jetë", "ekzistencë". Brezi (shoka) i lidhur përreth barkut mund të simbolizojë qarkullimin e kohës, të cilës, sipas dhjatës së Perëndisë, i është e nënshtrueshme gjithçka në natyrë. Madje, sipas gjitha gjasave, ajo pjesë e brezit që gjendet direkt përpara, domethënë që mbulon pjesën e përparme të barkut, përgjigjej për ditën, për natën, d.m.th., për ekzistencën mbitorësore të njeriut; kurse ajo pjesë e brezit që mbulonte shpinën dhe gjendje mbas shpine, mbartte në vetvete kuptimin e territorit, natës, udhëtimeve nëntokësore të shpirtit (krahasojeni p.sh., me besimet e indigjenëve jugoamerikanë, për atë që vdekja e shoqëron njeriun gjithandej, duke shkelur pas thembrave të tij, d.m.th., duke u fshehur pas shpinës së tij), kësaj, brezi shndërrohet nga një objekt veshjeje në një objekt tashmë magjik, në fetish, në talisman. Përkatesisht, këputja ose humbja e brezit (siç më sipër përmendëm, këputje e rrethqarkullimit të kohës dhe jetës në natyrë) ka domethënie e humbjes së mbrojtjes, koritjes apo dhe vdekjes. Një interpretim i tillë i legjendës shqiptare tëcitur në fillim, na duket mjaft i arsyeshëm. Duke kryer dhunë incestuale, kumara e privoi motrën e tij (ndrikullën) edhe nga brezi magjik, duke kryer mëkat të dyfishtë ndaj saj. Megjithatë, nga pikëpamja e vetëdijës arkaike, incesti është po aq akt seksual legjitim, sa dhe çdo tjetër lloj i këtitillë (material mbi këtë na japin përvojat e kulturave pagane, të ruajtura në një masë më të madhe ndër sllavë, në të ashtuquajturën "svalnie grjeha" (një lloj orgjie seksuale pa dalim marrëdhëniesh farefisnore A. T), e cila ndodhte në natën e Ivan Kupalës), pas së cilës shfaqej ylberi si simbol i plleshmërisë dhe katarsisit mallëngjyes të natyrës.

Te po ai Afanasjev, lexojmë: "... një forcë magjike i jep Homerit brezit të Kipridës, endun fijesh ari: në të fshihej gjithë hijeshia, miklimi i dashurisë dhe dëshira e fshehtë që tundonte arsyen; duke përdorur këtë brez, Hera e joshi Zeusin..." (1,360). Disa thyerje të njëpasnjëshme na japin, megjithatë, shkas ta lidhim ylberin pikërisht me lidhjen martesore mitike dhe plleshmërinë. Përveç kësaj, në po atë libër të Afanasjev, ka lidhje dhe legjenda e mrekullueshme lituaneze për Laumën (nimfën qiellore) dhe Zotin e naltë Perkunas (analog me Perunin sllav, rrufehëdhës), çka me të vërtetë të çon ndërmend legjendën shqiptare për lindjen e ylberit.

Siç duket, gjer te ne ka mbërritur një nga variantet më të vona të legjendës për ylberin, e ngarkuar me didaktikën e përditshme, ndërsa, duke gjykuar nga përpjekja jonë e analizës mitologjike krahasuese, me tingëllimin e saj arkaik, kjo legjendë paraqet në vetvete një nga mitet marginale kozmogonike të krijimit të botës nga martesat e tokës me qiellin.

*Ligjëratë e mbajtur në Akademinë e Shkençave ruse "Saharov" me 3 mars 1999, në Konferencën mbi Ballkanistikën.



Nga VITA KOJA*

Turizmi është një dukuri që shoqërohet me spostimin e njerëzve nga një rajon që quhet destinacion emetues, drejt një rajoni tjetër (destinacioni pritës) për një kohë të caktuar... Në destinacionin turistik, turisti zhvillon një sërë veprimtarish, provokon investime, bën vlerësimin e ekonomik të bukurive natyrore të zonës, etj..

Duke analizuar potencialin natyror dhe trashëgiminë kulturore të zonës së Gollobordës mund të themi se kjo zonë është e justifikon veten për të qënë një destinacion turistik që mundëson zhvillimin e disa tipave të turizmit, kryesisht të brëndshëm.

Format me të cilat shfaqet turizmi janë të shumta. Kështu i parë në këndvështrimin gjeografik, sipas të cilit duke u nisur nga vendimi që merr subjekti (turistët) për të lëvizur, kemi të bëjmë me turizëm aktiv. Ndërsa i parë nga këndvështrimi ekonomik i cili i jep përparësi transferimit të të ardhurave nga vendi i banimit të turistëve në vende të tjera me potencial turistik, atëherë turizmi është pasiv. Zoan e Gollobordës përbën një vend pritës polifunksional ku ekzistojnë disa faktorë që i tërheqin vizitorët të lëvizin drejt saj.

Nga pikëpamja kohore e shpërndarjes së flukseve të turistëve brenda harkut kohor të një viti, kjo zonë është bisezonale, pasi fluksi turistik mund të përqëndrohet në dy stinë. Por, ajo mund të shërbejë si qendër turistike për zhvillimin e turizmit për sportet dimërore, dhe si qendër turistike për turizmin klimaterik veror.

Oferta turistike e ndërtuar mbi bazën e të mirave natyrore natyrore dhe shoqërore që ka zona e Gollobordës, im përgjigjet kërkesave turistike të moti- vuara: nga malli për vendlindjen, nga nevoja për ajër të apstër e klimë të shëndetëshme, nga dëshira për të ruajtur traditat kulturore, folklorike dhe religjioze si dhe nga aspekte të agroturizmit dhe ekoturizmit.

Qendra e turizmit klimaterik malor ngrihen në vende ku kushtet klimaterike janë më të mira se ato të vendbanimit të përhershëm. Klima është motivi kryesor tërheqës, që i shndërron këto vende në destinacione turistike. Zona jonë e Gollobordës karakterizohet nga një klimë me ajër të apstër dhe të shëndetëshëm që shkarkohet nga lartësia mbi nivelin e detit mbi 1000 metra, nga prania e pyjeve, nga ujjat e ftohtë si dhe nga fakti që kjo zonë është tërësisht em orientim bujqësor e blegtoral e larg zoanve industriale, faktorë këta që i motivojnë turistët potencialë në përzgjedhjen e destinacionit turistik në kërkim të kushteve më të mira. Të ardhur në këto zona për turizëm klimaterik, mund të jenë ish banorë të kësaj zone dhe të përdorin për



Golloborda si destinacion turistik

struktura akomoduese shtëpitë e tyre, por mund të jenë edhe epsrona të tjerë që udhëtojnë të shtyrë nga kurioziteti për këto vise dhe ëpr të kaluar disa ditë në ajrin e pastër dhe klimën e mrekullueshme të zonës sonë. Këta vizitorë mund të sistemohen në shtëpitë e fshatarëve si miq por dhe me qera. Pior mendoj që do të ishte me interes që të mendohej që në disa vende të spikatura si pranë burimeve të Mllaçës, Visharica, Corveni Kutell, Dobri Kutell, Mali i Mirakës, etj., të ngrihen edhe kampingje me struktura modeste akomoduese për të tërhequr grupe të organizuar, kryesisht fëmijë dhe pushues të brezit të tretë, ndryshe, pesnionistë nga qytetet rreth zonës. Ky do të ishte një apel për të gjithë banorët e zonës, për pushtetin lokal, si dhe për fondacione të ndryshme që veprojnë në zonë, për të ndihmuar banorët rezidentë në rinovimin e shtëpive të tyre ekzistuese sipas të gjitha standarteve për ejetesë normale, si dhe për përmirësimin e infrastrukturës, kryesisht rrejtit rrugor të fshatrave, fuqizimin e rrejtit elektrik, funizimin me ujë të pishëm etj..

Rritja e madhe e sporteve dimërore ka bërë që shumë vende me kushte klimaterike të përshtatshme, të afirmohen si qendra të paisura për këto veprimtari. Golloborda me malet e saj ofron mundësi për zhvillimin e sportit të skive, ku në fshatra të veçanta si Stebleva, Klenja etj., ky sport ka qënë traditë, duke u përfaqësuar e vlerësuar dhe në aktivitete kombëtare. Sporti i skive mund të organizohet në qendra të caktuara për të prituri turistët që vijën për pushime apo enkas për të ushtruar sportin e skive. Këto qendra ajnë të paisura me struktura pritëse dhe lokale për depozitim të skive. Gjithshtu ekzistojnë dhe qendra ku grumbullohen njëkohësisht dhe ata që pushojnë, edhe eskursionistët, të cilat, pra dhe këto janë

të apisura me struktura pritëse dhe parapritëse si restorante, parkingje etj.. Karakteristikë e përgjithshme e qendrave të skive është paisja e tyre me pista, me impiantet e ngjitjes, shkollën e skive, shërbimet tregtare, lokale argëtimi etj.. Zona jonë do të ishte shumë atraktive nëqoftëse do të mendohej për ngritjen e qendrave të tilla të kompletuara edhe me shkollën e trainimit të skiatoprëve, me qellim që tradita e nisur të vazhdojë edhe më tej, e këto si domos në Raduç, Vetarnik, etj..

Mali dhe deti mbeten mënyrat më klasike të pushimit, por për periudha të shkurtra, për fundjavë, për ditë festash etj, nevojat turistike mund të plotësohen edhe me udhëtime të shkurtra në mjedisin rural. Personat që spostohen nga vendbanimet e tyre të ëprehshëm dhe që duan të aklojnë një periudhë kohe larg këtyre vendbanimeve me mjedis të ndotura urbane, kërkojnë sisteme të tjera pushimi në vende rurale. Pritja e turistëve këtu mund të bëhet në hotele, pensione, kampingje, apartamente të lëna me qera, në shtypi të dyta të fshatarëve etj..

Agroturizmi përfaqëson atë lloj turizmi që është i lidhur me fshatin, ku krahas veprimtarive argëtuese turistike zhvillohen edhe veprimtari të tjera karakteristike të zonës si korrje, vjelja e frutave, përgatitja e ushqimeve, ëmbëlsira të veçanta punime artizanale etj.. Modeli i pushimit nëpërmjet agoturizmit nuk përfshin vetëm momentin e pushimit apo një argëtim të thjeshtë, por paraqet mundësi për t'ju përkushtuar veprimtarive që synojnë të pasurojnë personalitetin e turistit. Pra bëhet fjalë që të praktikohen pushime inteligjente, të stimuluar në mënyrë të kulturuar

ku koha kalohet sipas dëshirave të turistit. Format e agroturizmit janë të shumta. Ato ndryshojnë sipas vendeve dhe brenda vendit, sipas rajoneve për nga karakteristikat e pritjes, shqërbimete afuara, mjedisi, kushtet natyrore etj..

Agroturizmi ose turizmi rural është motivi më tërheqës për lëvizjet, kryesisht të shtetshatave të kësaj zone, drejt saj. Këta turistë mund të sistemohen në shtëpitë e tyre të dyta, në shtëpi të fshatarëve të dhëna me qera apo si miq të tyre. Gjatë qëndrimit turistik në kohë të ndryshme të vitit ato, krahas çfrytëzimit të të mirave turistike që afron destinacioni, mund të zhvillojnë një pushim aktiv reaktiv duke duke u angazhuar në punë të ndryshme të fshatit sipas stinës si: kositje bari, të korra, vjelje frutash, punime të ndryshme artizanale. Me interes do të ishte ripërtëritaj e punishteve për përpunimin e kosumeve popullore të zonës, për të cilat mund të themë se janë ndër më të bukurat.

Një element tjetër që motivon lëvizje drejt një destinacioni pritës është edhe prania e qendrave apo objekteve religjioze. Qendrat e pelegrinazhit dallohen se janë krijuar e zhvilluar pranë një ndërtese ose një kompleksi ndërtesash, të afta për të tërhequr mijëra e mijëra peligrinë, për motive të ndryshme. Vënde apo objekte kulturi em cilësi të tilla ekzistojnë edhe në Gollobordë. Këtu, në vëndine quajtur Zveti Ilia (Shën Ilia) në fshatin Gjinovec, çdo vit më 2 gusht grumbullohen peligrinë, kryesisht të besimit ortodoks nga të gjithë fshatrat e Gollobordës, qytetet ku jetojnë gollobordasit, për të zhvilluar ritet e fesë së Shën Ilias. Selioshte në Klenjë, i njohur em ëktë emër që prej em shumë se 500 vejtësh, është vendi ku më 5 dhe 6 maj të çdo viti festohet Shën Gjergji, nga besimtarë e dy besimeve (myslimanë e të krishterë). Po kështu vende të shenjta që motivojnë spostime

peligrinë për motive fetare në zonë mund të përmendet edhe "Marko Dobica" në Stebelëv, etj..

Turizmi i zhvilluar në hapësirat e mbrojtura që karakterizohen nga një bukuri natyrore spikatëse dhe interesi ekologjik, quhet ekoturizëm. Ekoturizmi mund të gjeneroj në të ëvrtetë të ardhura të larta për ekonominë lokale e rajonale; të stimulojë qëndrimin publik dhe atë zyrtar në drejtim të ruajtjes së mjedisit. Ekoturizmi kombinon kënaqësinë e zbulimit e të përjetimit të florës e faunës me mundësitë për të kontribuar në ruajtjen e tyre. Ai mund të përkufizohet si udhëtim në zonat natyrore të qeta dhe të pa ndotura, si një veprimtari njerëzore që respekton dhe shfrytëzon pasuritë natyrore dhe harmonizon njeriun me mjedisin, ku si objekt kryesor i tij është studimi, admirimi, përjetimi i pamjeve dhe botës së gjallë si dhe të çdo manifestimi kulturor të pranishëm në këto zona.

Ekoturizmi fillon me një shëtitje të zakonshme përmes një pylli të qetë deri në eksplorimin dhe studimin e karakteristikave natyrore origjinale të viseve të largëta. Parqet natyrore, rezervatet e gjetisë, peizazhet e mbrojtura etj, janë rajone ekoturistike që tërheqin vëmendjen e turistëve për vlerat rekreative, edukuese dhe estetike të tyre.

Shërbimet bazë për zhvillimin ekoturizmit, për t'a bërë atë një afktor të rëndësishëm ekonomik të një rajoni, janë sigurimi i transportit dhe infrastruktura, ndërkohë që për kushtet e sistemit dhe të ushqimit kërkesat mund të ejnë shumë modeste. Ndërtimet në këto qendra turistike janë të kontrolluara dhe në harmoni të plotë me mjedisin për rreth. Qendrat turistike të ekoturizmit janë mjedis të mbrojtura, të cilat janë të vendosura në relieve dhe kushte klimaterike të ndryshme.

Ata paraqesin ekosisteme të cilat nuk mund të transformohen nga veprimtaritë e njerëzve, qofshin këto rezidentë apo turistë. Bota bimore dhe shtazore në këto mjedis ka interes të madh nga pikëpamja shkencore dhe ekoturistike. Pyjet e bukur, kullotet alpine në Raduç, Kallkan, Visharica, Dragan, Mali i Letmit, Steblevë, Moglicë, Okshtun, Prodan, etj, ajnë njëra prej atraktivë për ngulmim turistike apo dhe ekskursionet. Por ato duhet të zhvillohen si zona turistike të mbrojtura për të ruajtur bimesinë, lulet e rralla, duke kontrolluar grumbullimin bimeve medicinave nga më të shumëllojshmet, gjetinë etj..

Së fundi, del se destinacioni turistik i Gollobordës me ofertën e tij hynë në tregun turistik për atë segment të kërkesës të përbërë kryesisht nga banorë të saj të shpërngulur në qytetet më të mëdha të Shqipërisë, të motivuar kryesisht nga malli për vendlindjen, nga miqësitë e tyre etj.. Gjithashtu për këtë destinacion mund të ektë interes edhe nga vizitorë të brëndëshëm, të huaj, të motivuar nga kurioziteti, natyra e bukur apo dhe biznesi për të çfrytëzuar burimet natyrore si lëndë drusore, ujjat e kristalta, bimesinë etj..

* Autorja është pedagoge në Fakultetin Ekonomik, Tiranë.

Prof. ass. dr. ADEM BUNGURI

Në periudhën 27 gusht-12 shtator 2007 në vendbanimin neolitik të Burimit u kryen gërmime arkeologjike me karakter kontrolli. Qëllimi i tyre ishte përcaktimi i karakterit kronologjik të depozitimeve të kulturës së Burimit, e njohur në literaturën tonë arkeologjike nga gërmimet e para me karakter sondazhi të kryera aty nga Zh. Andrea që në vitin 1978¹ dhe nga studimi që i ka bërë kësaj kulture autorja së bashku me prof. F.Prendi². Gjatë kësaj fushat u gërmua një sipërfaqe prej 50m² e ndarë në 4 kuasdrate, mjaft të shpërndara në hapësirën e vendbanimit³.

Ku ndodhet vendbanimi ?

Vendbanimi është identifikuar për herë të parë nga kolegu ynë I. Kaca në fundin e viteve 70'. Ai shtrihet në një fushë të sheshtë aluvionale në jug të fshatit Burim, të njohur me emrin "Livadhi i madh" dhe kufizohet nga veriu me "përroin e lugjeve", nga jugu me "kodrën e mullirit", nga perëndimi me "fushën e paraspoëve" dhe nga lindja me "fushën e hamllave". Afër gjysmës së saj veriore, kjo fushë ndahet nga rruga e arave dhe kanali i drenazhimit me drejtim lindje-perëndim në dy blloqe të veçanta të njohura me emrin "Ara e Dacit" dhe "Ara e Demës". Ara e Dacit, me formë të regullt katërkëndëshe, në anët lindore dhe jugore kufizohet nga dy kanale drenazhuese me drejtim veri-jug dhe lindje-perëndim, ndërsa në perëndim takohet me fushën e paraspoëve. Brenda këtyre kufijëve, pjesa e banuar e saj me përmasa 180x116m arrin në 2,088 ha, ndërsa ajo e Arës së Demës në 0.5 ha. Sipërfaqja e përgjithshme, por e përafërt e vendbanimit arrin kështu në mbi 2.5 ha. Burimi përfaqëson kështu një nga vendbanimet më të mëdha në Shqipëri e viset fqinje.

Çfarë sollën gërmimet e reja?

Gërmimet tona u përqëndruan në fushën e quajtur "Ara e Dacit", në pronën e z. Ibrahim Asllani, ngjitur me arën e z. Izet Tonuzi, ku duket se ndodhet edhe epiqendra e vendbanimit neolitik. Si pikë "0" e matjes së kuotave u caktua skaji verilindor i arës së I. Asllanit, buzë kanalit të drenazhimit dhe rrugës së arës në fjalë (ku kemi vendosur shufrën e hekurit). Lartësia e instrumentit nga pika 0 është 1.70 m. U gërmuan gjithsej 6 kuasdrate, të vendosura si më poshtë: kuadr. I-III me përmasa 2x2m u vendosën në pjesën qendrore të arës, duke filluar nga distanca 20 m në jug të kanalit verior dhe pikës 0 dhe u gërmuan sipas parimit të alternuar, kuadr. IV me përmasa 4x4 m u vendos 17 m në jug të kuadr. III, kuadr. V me përmasa 3x3 m, u vendos 14 m në veri të kuadr. III, dhe kuadr. VI me përmasa 2x2m u piketua 30 m në jug të kuadr. V, në të njëjtin drejtim me të. Sipërfaqja e përgjithshme e gërmuar arrin kështu në 41 m².

Shtresa kulturore me trashësi 1-1.20m është e njëtrajtshme dhe ka përbajtje të njëjtë kulturore. Ajo përbëhet nga dy horizonte banimi, të zbuluara përkatësisht në thellësitë 1.00-1.10m dhe 0.40-0.50m. Më i plotë dhe më i qartë ruhet horizonti I i banimit, kronologjikisht më i vjetër, ndërsa horizonti II i mëvonshëm, zakonisht është i dëmtuar nga punimet e thella të fushës me traktor, dhe ruhet në trajtë gjurmësh të vogla dyshemeshe argjilore. Horizonti I ka trashësinë e depozitimeve 0.40-0.45 m, horizonti II 0.40-0.46 m dhe shtresa humusore 0.22-0.27 m. (Fig.2. Profili verior i kuadr. II)

Dyshemeja e horizontit I më të hershëm është vendosur menjëherë mbi taba-

BURIMI – një nga vendbanimet neolitike më të hershëm në Shqipëri



Fig.1. Pamje e përgjithshme e vendbanimit të Burimit

nin natyror argjilo-flislor të vendbanimit. Meqenëse niveli hidro-stratik i ujrave është i lartë, banorët e hershëm neolitik të Burimit, kanë ndërtuar banesat e tyre, duke synuar hidroizolim sa më efikas të të dyshemeve të banesave të tyre. Kështu, në fillimet e jetës së këtij vendbanimi, këto dysheme janë ndërtuar nga një platformë e rallë kalldrëmore gurësh të vegjël lumorë, të plotësuar edhe me fragmente të ralla enësh, mbi të cilët ka qenë shtuar një shtresë llaçi argjilor, e cila nuk ruhet gjithnjë e plotë (fig. 3-Pamje nga dyshemeja e kuadr. III). Shtresa e dyshemesë argjilore, me trashësi 8-10 cm e gatuar prej argjili të pastruar nga gurët dhe të përzier me byk gruri, është e pjekur dhe ka ngjyrë të kuqe tulle. Kjo teknikë e ndërtimit të dyshemeve neolitike të hershme, përveç Burimit, është konstatuar edhe në mjaft vendbanime neolitike të Shqipërisë si në atë të Topojanit (gradishta e Vojnikës-Dibër), Kosovës, si në atë të Vlashnjës (Prizren), Rudnikut (Skënderaj), në disa vendbanime të Thesalisë e Maqedonisë etj. Dyshemeja kalldrëmore e Burimit shquhet për një teknikë fillestare të ndërtimit të saj. Gurët lumorë të madhësisë mesatarë e të vegjël janë të rallë dhe nuk e mbulojnë të gjithë sipërfaqen e dyshemesë. Boshllëqet midis tyre janë mbushur me argjil të pjekur në

ngjyrë tulle dhe në ndonjë rast edhe me fragmente enësh. Me këto tipare teknike dyshemeja me substruksion gurësh kalldrëmore e Burimit paraqet një nga shembujt më të hershëm të këtij lloji ndërtimi të njohur deri tani në Ballkan.

Dyshemeja e horizontit II të banimit është ruajtur vetëm pjesërisht. Ajo është zbuluar në kuadr. I (0.80x0.90m), në kuadratin II me përmasa 1.15x1.10m, në kuadratin III (0.50x0.60m), Më e qartë ajo u zbulua në kuadr. II, ku, në thellësinë 0.40-0.50 m, ruhej një pjesë dyshemeje e ndërtuar vetëm me një shtresë llaçi argjilor, të vendosur mbi trarë druri horizontalë dhe mbi gurë të vegjël. Gjurmët e këtyre trarëve janë ruajtur të fiksuara në faqen e poshtme të rrënojave arkitektonike të dyshemesë. Ato kanë seksion gjysëmrrthor djshme diametër 0.05-0.08 m. Rrënojat e dyshemesë argjilore nga pjekja ka marrë ngjyrë të kuqe tulle. Në kuadratin II, në thellësinë 0.48-0.50 m u gjetën tri gjurmë shtyllash veritike druri të ndërtimit të kasolleve. Këto vrima shtyllash kanë formë rrethore me diametër 0.10-0.12 m dhe përmbajnë pjesë të karbonizuara të druërve, që kanë shërbyer si shtylla, të cilat u muarën për analiza radiocarbonike. Ato janë vendosur 0.50-0.60 m larg njera tjetrës dhe krijojnë një planimetri eliptike. Është kjo një e dhënë e rëndësishme që fitohet për herë të parë lidhur me planimetrinë e banesave neolitike të hershme të Burimit. Në pjesët e dyshemeve të lëvizura nga punimet, vlejnë të përmenden disa fragmente rrënojash me faqen e sipërme të sheshuar dhe të lyer me një llojë ajke argjilore të përzier me hi zjarri, që u jep atyre lëmueshmëri dhe shkëlqim, gjë që i bën banesat më të pastra e higjienike

ato prej kocke. Megjithëse në shtresën kulturore nuk i gjet asnjë vegël pune prej kocke, duhet thënë se ato duhet të kenë qenë përdorur gjërisht nga banorët e Burimit, nisur nga numri relativisht i lartë i gurëve të grihës, të përdorur për mpresjen e veglave prej kocke.

Në veglat prej guri përmendim mokrat e blojës, që krahas bykut të grurit dëshmojnë njohjen dhe zhvillimin e bujqësisë primitive. Një vend të veçantë zënë sëpatat e tipeve të njohura neolitike, në trajtë gjihe e kallëp këpuce, ato në trajtë sqeparësh dhe daltash si dhe lëmueset e vogla prej guri të enëve gjatë modelimit. Shihet se këto vegla janë prodhuar në vend nga gjetja e disa bërthamave të papërfunduara të sëpatave me forma konike si dhe disa ashklave prej shkëmbinjsh ultrabazikë të njëjtë me ato të sëpatave.

Veglat prej stralli janë më të pakta. Ndeshen kryesisht krusewt fundore dhe anësore, thikat me tehet gjatësore, shpueset etj. Ashtu si veglat prej guri edhe ato prej stralli janë prodhuar në vend, nisur nga sasia e madhe e ashklave të strallit si dhe nga gjetja e disa nukleusave të tyre.

Materialin më karakteristik të kulturës së Burimit e përbën qeramika. Në bazë të stratigrafisë, teknikës, sistemit dekorativ dhe tipologjisë së saj, rezulton se kjo kulturë përfaqëson një fazë më vete dhe shumë të hershme të zhvillimit neolitik të vendit tonë. Nga pikëpamja e teknikës së punimit, qeramika paraqitet me fakturë të trashë, të zakonshme dhe relativisht të hollë. Mbizotëron dukshëm qeramika me punim të trashë, prej balte të papastruar, me përzierje rëre dhe grimcash gurësh, që shpesh dalin mbi faqet e jashtme dhe të brendshme të enëve, në përgjithësi poroze dhe jo të sheshuara me kujdes, pa lyerje sipërfaqësore, me përjashtim të disa rasteve të ralla, ku kjo lyerje ndeshet vetëm në faqet e brendshme të tyre. Kjo qeramikë është e pjekur dobët, gjë që shihet në bërthamën e saj të papjekur mirë me ngjyrë të errët. Pjesa më e madhe e enëve me fakturë të trashë ka nuanca të kuqremee dhe kafe të çelët, shumë të ralla janë fragmentet okër të çelët, gri në të zeze etj.

Në këtë kategori qeramike, veçohet një grup i vogël fragmentesh, të gjetura në nivelet e poshtme të shtresës kul-

Analiza e lëndës arkeologjike

Lënda arkeologjike e zbuluar është relativisht e pasur. Ajo përbëhet kryesisht nga fragmentet e enëve, veglat e punës prej guri dhe stralli, ndërsa mungojnë në pjesën e gërmuar veglat prej balte dhe



Fig.2. Profili verior i kuadr. II

turore të kuadr. IV-V (në thellësitë 0.90-1.10m), që i përgjigjet fillimeve të jetës në këtë vendbanim. Fjala është për disa fragmente enësh me ngjyrë kafe të errët ose kafe në të kuqe, me brum të papastuar nga gurët dhe me pjekje shumë të dobët. Ajo është aq e brishtë sa që shkohet sapo futet në ujë, ashtu si një kokër sheqeri në një gotë çaji. Ajo është krejtë e ngjashme me qeramikën e këtij tipi të Sidar C basse të Korfuzit, atë të vendbanimit shpellor të Franchthi Cave në Peleponez, qeramikën e niveleve më të poshtme të Sesklos (sektori A dhe C) si dhe me atë të Skarin Samogreadit të Dalmaci. së qendrore. Pikërisht këto pak fragmente përfaqësojnë sipas mendimit tonë, prodhimet e para të poçerisë së Burimit dhe e rrjeshtojnë Burimin, krahas elementëve të tjerë që do të përmenden më poshtë, në vendbanimet më të hershme ballkanike të neolitit të hershëm qeramik.

Qeramika e zakonshme është e punuar nga i njëjti brum me përzjerje rëre që del mbi sipërfaqe, por i pastuar nga grimcat e gurëve. Ka gjithashtu sipërfaqe poroze pa lustër, ashtu si edhe qeramika me frakturë të trashë. Është e modeluar dhe e pjekur më mirë. Ka ngjyra të kuqërremta dhe më pak të kafërremta, sikurse dhe ajo me fakturë të trashë, dhe rallë ndeshen ngjyrat e errta.

Qeramika me fakturë relativisht fine monokrome është dukuri shumë më e rallë. Ajo është punuar prej balte të pastuar dhe të ngjeshur mirë, me përbërje rëre të imtë. Pjekja dhe këtu gjithashtu nuk është e plotë, ndërsa shumë rallë ndeshetq lustar e faqes së jashtme në trajtë angobe të paqëndrueshme.

Format e enëve në përgjithësi riprodhojnë trajta të ngjashme me ato të grupeve fqinje neolitike të hershme. Forma kryesore përfaqësojnë enët me trup sferik e gjysëm-sferik, me profilim të ndryshëm të grykës, apo trungkonikë si edhe ato me tendencë bikonizmi, megjithëse shumë të pakta. Vegjet janë shfaqje e rrallë. Më karakteristike janë ato tunelore dhe ato të vogla shiritore. Fundet në përgjithësi janë të sheshtë e më rrallë unazorë ose me këmbë të lartë trungkonike..

Zbukurimi në qeramikën e Burimit është i thjeshtë. Mbizotëron ornamentet barbotin. Me përdorim më të gjërë është zbukurimi me spërkatje të çregullt në trajtë spruce, ose i tipit fshesor, dhe me rallë ai i organizuar në formë hullishë. Zbukurimi impresso është 5 herë më i pakët nga ai barbotin (1:5). Mbizotëron dekorimi me pickim thoji, ndërsa ai me instrument është një shfaqje sekondare. Janë përfaqësuar si motive gropëzat e cekta dhe vijat e shkurtëra. Duke pasur parasysh karakterin primar të këtyre elementëve në qeramikën e kompleksit neolitik të hershëm adriatiko-mesdhetar, mund të mendohet që shfaqja e tyre në këtë kulturë të jetë shprehje e kontakteve të ngushta të saj me grupin e kulturës impresso-cardium të rajoneve perëndimore të vendit. Elementë tjerë dekorativë si inçizimet dhe thimthast plastikë janë shfaqje sporadike dhe pa vlera determinuese në sistemin dekorativ të kësaj poçerie.

Zbukurimi më inçizim është akoma më pak i përdorur. Motivi përbëhet nga vija të drejta ose zigzage të grupuara në sisteme vertikale apo të tërthorta, tipike për kulturën Starçeco, ndërsa zbukurimi plastik në trajtë thimthast është një dukuri shumë e rallë.

Qeramika e pikturuar nuk u gjet në asnjë rast, ashtu si dhe në gërmimet e vitit 1978. Kjo që do të thotë se banorët e Burimit ende nuk e kishin njohur këtë teknikë të re dhe më të avancuar dekorative. Kjo është një e dhënë shumë e

rëndësishme për kronologjinë e Burimit dhe sigurisht flet për një fazë të heshme protostarçevo të kulturës së tij. Objektet e kultit përfaqësohen vetëm nga një këmbë tavoline kulturi, e pazbukuar, si dhe një pintaderë e vizuar me motive zigzake, e përdorur për zbukurimin e brumit të bukës.

Cila është kronologjia e Burimit?

Lidhur me kronologjinë e kulturës së Burimit, dhe vendin që ajo zë në zhvillimin neolitik të vendit tonë, duhet vënë në dukje në radhë të parë karakteri në përgjithësi shumë trashanik i punimit të qeramikës si dhe kategoritë më karakteristike të saj, si qeramika mbizotëruese barbotine dhe ajo më e kufizuar impresso, qeramika e paktë monokrome e kuqe pa shkëlqim, dhe mungesa e plotë e dekorit të pikturuar etj. Këto kategori qeramike të kujtojnë në përgjithësi tiparet e fazës më të hershme të grupit kulturor të Starçevos (Protostarçevo e Starçevo I)⁴, me të cilën duhet lidhur pa dyshim edhe kultura e Burimit, qoftë dhe si një variante periferike juglindore e saj.

Në këtë kontekst, Burimi do të përfaqësojë shfaqjen më të hershme të zhvillimit të neolitit të hershëm qeramik



Fig.3. Pamje nga dyshemeja kalldrëmore e kuadr. III

në Shqipërinë lindore. Mbi bazën e kësaj kulture protostarçeviane të Burimit, do të formohet më vonë kultura Kolsh I (Kukës), si një variante periferike e kulturës klasike të Starçevos (Starçevo II-b), me disa elemente qeramike më të zhvilluar dhe të panjohur nga Burimi.

Lidhur me kronologjinë relative të kësaj kulture, të dhëna interesante ofron tabloja stratigrafike e vendbanimit prehistorik të Sidarit⁵ në veriperëndim të Korfuzit, e cila u konfirmua më vonë edhe në vendbanimin shpellor të Franchthit në Peleponez⁶ si dhe në Skarin Samograd⁷ të Dalmacisë qendrore,

Në Sidar horizonti më i hershëm neolitik me qeramik të thjeshtë monokrome dhe vegla të bollshme stralli jo mikrolitike, me trashësi 0.50-0.60m (Sidar C Base) ishte vendosur direkt mbi atë të mezolitit (Sidar D), ndërsa sipër tij vijojnë një hiatus steril aluvional me trashësi 0.70-0.80m (Sidar C Middle) si dhe horizonti me qeramikë impresso tipike neolitike, i shoqëruar me shumë vegla stralli, me trashësi 0.15m (Sidar C Top). Cilësia e punimit të kësaj poçerie është aq e dobët dhe primitive, sa që fragmentet e enëve, ashtu si dhe ato të Burimit, thërmohen sapo futen në ujë, ashtu si një kokër sheqeri në një gotë çaj, duke përdorur në këtë rast termin e A. Sordinas. Pjekja është dobët, gjë që shprehet në ngjyrën më të errët të gjysmës së brendshme të murit, në raport me atë të sipërfaqes së jashtme, ndërsa lëmimi është i njëjtë në të dy faqet. Kjo poçeri dallohet për ngjyrën e thellë monokrome okër në kafe, por jo të kuqe. Përveç kësaj, ndryshe nga qeramika monokrome e kuqe, kjo qeramikë paraqitet e zbukuar me inçizim të thellë, me një instrument të

mprehtë. Motivet janë të thjeshta dhe përfaqësohen nga zona të njëpasnjëshme dhe të pargullta, të mbushura me vija paralele, të cilat priren drejt zonave koncentrike ose vertikale në lidhje me buzën⁸.

Në Franchthi cave K.Vitelli ka studiuar një grup të vogël prej 25 fragmentesh qeramike, nga një depoziotë aqermike e shpellës, që i takojnë sipas saj fazës FCP1 të banimit sezonal të shpellës (1993 a, 213). Ato ndryshonin nga trashësia e pareteve, këndi i buzëve dhe kurbatura e profilit. Gjithashtu ato ruanin gjurmët e pjekjes në zjarre të hapura, pjekje që cilësohet e dobët. Numri i enëve të tilla të hershme të prodhuara në një vit nga komuniteti i këtij vendbanimi shpellor, është shumë i kufizuar dhe sipas llogaritjeve të autorit arrihet në 12-13⁹.

Veçoritë teknike të qeramikës së hershme të Burimit, e afrojnë atë me qeramikën e hershme të Thesalisë (Frühkeramikum) dhe fazën më të hershme të Elateas¹⁰, ndërsa në Shqipëri, siç ka vënë në dukje prof. F.Prendi, me qeramikën e thjeshtë monokrome të Vlushës¹¹, e cila, siç dihet, shoqërohet me shumë mikrolite të sileksit tipik mezolitik. Në aspektin teknologjik kjo qeramike monokrome e inçizuar, është mjaft e afër me qeramikën e inçizuar të Burimit, ngjashmëri që na duket e rëndësishme, qoftë edhe për të vënë paralele kronologjike midis tyre.

Kërkimet e fundit arkeologjike dhe krahasimet e vendbanimit e reja me një stratigrafi të sigurt vertikale e horizontale të Maqedonisë e Thesalisë kanë vërtetuar se shfaqja më e hershme e zhvillimit të kulturës Starçevo, me të cilën lidhet dhe Burimi, i duhet atribuar plotësisht neolitit të hershëm qeramik, në kuptimin e periodizimit të përgjithshëm të neolitit të gropës juglindore të Ballkanit, dhe mund të paralelizohet direkt me fazat II-IV të grupit Anzabegovo-Vrshnik të Maqedonisë dhe Sesklo të Thesalisë. Në këtë kontekst Burimi do të mund të sinkronizohet në kuptimin e stratigrafisë së neolitit maqedonas, me fazën neolitike të hershme të neolitit maqedonas, atë protostarçevo të neolitit thesalian dhe atë protostarçevo të neolitit të hershëm ballkano-qëndror. Ai do të përfaqësojë kulturën më të hershme të neolitit të hershëm qeramik në të gjithë territorin e Shqipërisë, duke mos llogaritur këtu fazën e neolitit të hershëm pa qeramikë, të njohur në kohët e fundit edhe në pellgun e Korçës (Sovjan), ashtu si në Thesali. Shpresojmë se analizat e C-14 të mostrave të drurëve të karbonizuar do të sjellin të dhëna ndihmëse në mbështetje të kronologjisë së lartë relative dhe absolute të Burimit, e cila, paraprakisht mund të thuhet se fillon aty nga gjysma II e mijëvjeçarit VII para Kr(pas viteve 6500 p.Kr).

¹ Zh. Andrea, Raport mbi gërmimet e sondazhit të vitit 1978 në fshatin Burim të Maqellarës, Arkivi i Institutit Arkeologjik, nr. Inv. 3978, f. 1-4.

² F.Prendi-Zh.Andrea, Të dhëna të reja mbi neolitit në Shqipëri, Iliria 1981, 2. f. 17-19, tab.I-II

³ Zh. Andrea, Raport mbi gërmimet e sondazhit të vitit 1978...f. 1-4.

⁴ A. Benac, Prelazna Zona, Praistorija Jugoslavenskih Zemalja II, Sarajevo 1979, f. 133.

⁵ A. Sordinas, Investigations of the prehistory of Corfu during 1964-1966, Offprint, "Balkan Studies", 10, 2, Thesalonik 1969, f. 401.

⁶ D.Bailey, Balkan Prehistory, Exclusion, incorporation and identity, New dimensions of material Culture, London 2000, p.77-80.

⁷ J. Müller, Skarin Samograd eine frühneolithische Station mit monochromer Ware und Impresso Keramik am der Ostadria, "Archaologisches Korrespondenzblatt", 18, 1988, Haft 3, f.219-234.

⁸ A. Sordinas, Investigations...f. 406, tab.III:

⁹ D.Bailey, Balkan Prehistory, Exclusion, incorporation and identity, New dimensions of material Culture, London 2000, p.78-79.

¹⁰ A. Sordinas, Investigations... f. 406.

¹¹ F. Prendi, Le Neolithique Ancien en Albanie, Germania 1990, 68, Halband 2, f. 423.

Reagim i Drejtorisë së Festivalit „Teatri Shqiptar në Maqedoni-Dibra 2007“ ndaj shkrimit me mbtitull „POST FESTIVAL“ dhe me titull „JULUMTË DIBËR!“ shkruar nga Valbona Zunçe dhe Atli Dema, botuar në „Rruga e Arbërit“ nr.9 shtator 2007.

Festivali meriton lëvdata e jo kritika të pabaza

Drejtorja e Festivalit „Teatri Shqiptar në Maqedoni - Dibra 2007“, reagon ndaj shkrimit të lartpërmendur të gazetarëve Valbona Zunçe dhe Atli Dema dhe njofton auditorin e gjerë se:

1. Festivali „Teatri Shqiptar në Maqedoni-Dibra 2007“ ftesat për pjesëmarrje i ka adresuar më 30 Qershor 2007, fillimisht te institucionet e teatrove kombëtare, te TK- Tiranë; TK- Prishtinë dhe TSH -Shkup, etj. TK- Tirane dhe TK - Prishtinë na lajmëruan se me shfaqjet e tyre për arsye objektive (probleme të tyre të brendshme) nuk mund të marrin pjesë në Festivalin tonë, ndërsa nga TSH- Shkup nuk morëm asfarë përgjigje.

2. Politizimi, apo më mirë me thënë partizimi i Festivalit, (citat i dy gazetarëve) është i papranueshëm dhe tendencioz, sepse z.Ali Ahmeti, ndau çmimin e shfaqjes më të mirë të Festivalit, çmimin „Sulejman Pitarka,“ në cilësinë e një lideri artdashës dhe i denjë për të përshëndetur të pranishmit, sepse sponsori gjeneral dhe i vetem i Festivalit ishte Komuna e Dibrës.

Gazetarët, duhet të kuptojnë, se në ditët e sotme në shekullin XXI shumëçka është politikë, sidomos në Republikën e Maqedonisë. Politikë është edhe mosmbështetja financiare e Festivalit tonë nga Ministria e Kulturës e Maqedonisë dhe politikë është edhe mosprezenca e Ministrisë (shqiptar) të Kulturës të Maqedonisë, në eventimentin më të rëndësishëm, siç është Festivali „Teatri Shqiptar në Maqedoni-Dibra 2007“.

3. Në bazë të rregullores së festivalit, sipas kriterëve të ndarjes së çmimeve, kryetari i jurisë ka të drejtën e vetos që për një çmim të vetëm të vendos vetë. Kjo nuk do të thotë që edhe Drejtorja e festivalit dhe stafi i tij pajtohen me veton e kryetarit të jurisë. Juria është e pavarur nga Drejtorja në vendosjen e çmimeve. Ne si drejtori do ta ndryshojmë rregulloren.

4. Pjesëmarrja e shfaqes „Stjuardesa“ nga kompania „Kult“ e Kumanovës në edicionin e gjashtë të këtij eventimenti që përkon me të njëjtën shfaqje të edicionit të parë, nuk ka asgjë të keqe, sepse ne shohim dy platforma të ndryshme regjisoriale, dy trupa të ndryshëm aktorësh dhe plotësojmë ose pasurojmë më shumë njohjen e aktoreve dhe regjisorëve në kuptimin më pozitiv për të krijuar mendim për një vepër dramaturgjike e vënë nga dy trupa dhe dy regjisorë të ndryshëm.

5. Sa i takon përgjedhjes së trupave pjesëmarrëse në këtë festival, përgjigja jonë është se, ne nuk mund të ndërhyjmë te konfirmimi ose jo i institucioneve teatrore për pjesëmarrjen e tyre.

6. Çmimi „Sulejman Pitarka“ ishte çmimi i shfaqjes më të mirë të Festivalit dhe u dha gjithsesi, e për këtë mund të kontaktoni me fituesin, TK- Gjakovë.

7. Përkrahja dhe mbështetja e Komunës së Dibrës për Festivalin, sigurisht që është nisma për institucionalizimin e tij, por gjithsesi lypset edhe mbështetja financiare nga Ministria e Kulturës e Maqedonisë, e cila mbështeti shumë projekte në lëmin e kulturës në Maqedoni, por nuk e mbështeti Festivalin e teatrove në Dibër.

Është e vërtetë se Festivalin e teatrove në Dibër e ndoqën mbi 6 mijë spektatorë, është e vërtetë se festivali bëhet në Dibër, është e vërtetë se festivali është mbarëkombëtar, është e vërtetë se është festivali më i organizuar në hapësirat shqiptare, është e vërtetë se Qendra për Kulturë-Dibër na mori për shfrytëzimin e sallës afër 5 mijë euro, por nuk mund të jenë kurrë të vërteta pretendimet e gazetarëve Valbona Zunçe dhe Atli Dema në pjesën më të madhe të tekstit të tyre të botuar.

**Ylber Nuredini,
Drejtor i Festivalit „Teatri Shqiptar
në Maqedoni - Dibra 2007“**

SHËNIM I REDAKSISË: Në mungesë të një marrëveshjeje paraprake me të gjithë bashkëpunëtorët e gazetës sonë, redaksia e boton të plotë reagimin e Drejtorit të Festivalit, pavarësisht se nuk është dakord me dy paragrafë të këtij shkrimi, ku atakohen direkt dy bashkëpunëtorët e saj. Duhet të sqarohet me këtë rast se nuk jemi të angazhuar për shndërrimin e faqeve të gazetës në shesh replikash personale. Redaksia mbetet e hapur për ta zhvilluar debatin kur ajo ka vlerë institucionale dhe mendimi kritik, por nuk jep mbështetje për njërin apo tjetrin palë, kur debati nuk i shërben frymës së kritikës dhe mendimit, të cilin ne mbetemi të angazhuar për ta zhvilluar më tej. Redaksia mbetet e hapur për gjykime e vlerësime, por duke mënjeluar reagimet direkte ndaj personave, për sa kohë ato nuk janë institucionale.

Letër e hapur Qeverisë së Shqipërisë, Qeverisë së Kosovës, Lidhjes Shqiptare në Botë, Këshillit Kombëtar Shqiptaro-Amerikan dhe biznesmenëve shqiptarë

Libri që duhet përkthyer dhe shpërndarë urgjentisht në tërë botën



Nga Rexhep TORTE

Zvarritja e Pavarësisë së Kosovës përmes afateve të reja për bisedime, përkundër një lufte serbe gjenocidiale në Kosovë kaqë shkatërrimtare e dëmprurëse kundër shqiptarëve, hudhja me një anë edhe e Planit të Ahtisarit, ku shqiptarët tregohen garantuesit më të mëdhenj në botë për pakicën serbe që është më pak se dhjetë për qind, përbën sinjalin më të kobshëm në dem të çështjes së Kosovës.

Ringjallja e çuditshme, e pafytyrshme dhe tejet agresive e diplomacisë serbo-ruse kundër Pavarësisë së Kosovës. Synimet dhelpanake serbo-ruse për të futur sërish nën kthetrat e tyre Kosovën. Arsyetimet serbo-ruse, qesharake, neveritëse dhe pa asfarë baze, që mundohen ta arsyetojnë pse ua ka ënda ta shtijnë sërish në

“Rrëfimet e femrave të dhunuara gjatë luftës në Kosovë” i autores Luljeta Selimi, mbetet argumenti më i fuqishëm për diplomacinë dhe lobimin për Pavarësinë e Kosovës

dorë Kosovën. Aktivizimi dhe forcimi i enklavave serbe në Kosovë dhe paralajmërimi i gardës së “Car Lazarit” dhe të vullnetarëve tjerë serbë për protesta në veri të Kosovës, më shumë se kurrë ndonjëherë imponojnë nevojën që në argumentet diplomatike dhe të gjithanshme shqiptare në arenën ndëkomëtare për Pavarësinë e Kosovës, të zë vend edhe libri “Rrëfimet e femrave të dhunuara gjatë luftës në Kosovë” i autores kosovare Luljeta Selimi.

Negociatat

Kjo hiq më pak, se sa për t’ia thyer hundët diplomcisë së fëlliqur serbo-ruse, këtij binomi që gadi një shekull çdo pëllëmbë tokë e ka larë me gjakun e shqiptarëve autoktonë kosovarë, e tani me argumente nga më banalet po i kundërvihen Pavarësisë së merituar Kosovës.

Sensibilizimi i efektshëm që arriti te lexuesit botimi i fejtimit të librit të Luljeta Selimit “Rrëfimet e femrave të dhunuara gjatë luftës në Kosovë”, botuar në të përditshmen “Fakti” në Shkup nga data 20 gusht

deri më 1 shtator, më nxitën që të shkruaj edhe dy komentet e mia rekomanduese me mbititull “Kosovaret e dhunuara-argumenti më bindës për pavarësinë e Kosovës” dhe me titull “Libër që duhet përkthyer dhe shpërndarë në tërë botën”, të botuara në “Fakti” në Shkup dhe në mjetet e informimit në Tiranë, Prishtinë dhe në “Ylliria” në SHBA. Për fat të keq dhe të habitshëm askush gjer më sot nuk bëri asnjë lëvizje në këtë drejtim.

Nisur nga ky indiferentizëm i dëmshëm brendashqiptar për rëndësinë e këtij libri, kam vendosur edhe një herë ta ngre zërin tim si gazetari më i moshuar shqiptarë, që në të mirë të Kosovës dhe për t’ju kundërvënë sa më fuqishëm diplomacisë serbo-ruse dhe secilit që shpreh lëkundje për Pavarësinë e Kosovës, të apeloj te Qeveria e Shqipërisë, Qeveria e Kosovës, te Lidhja Shqiptare në Botë, te Këshilli Kombëtar Shqiptaro-Amerikan dhe te biznesmenët shqiptarë, që ky libër i Luljeta Selimit të përkthehet sa më parë në gjuhët angleze, frenge dhe gjermane, e tu dërgohet tërë ambasadorëve në

Kombet e Bashkuara, në Unionin Evropian dhe tërë burave shtetërorë, për të parë dhe për tu bindur se serbët përveç vrasjeve, djegieve në Kosovë kanë bërë edhe dhunimet nga më makabëre që mund ta imagjinojë mendja e njeriut dhe se një gjë të tillë nuk do ta bënin as shtazët më të egra.

Trishtimi

Siç thotë edhe vetë autorja, “Në çdo luftë dhunimet konsiderohen krimi më i rëndë. Kjo e vërtetë duhet të plasohet në opinion sado e dhimbshme që është, sepse shumë femra të përdhunuara edhe janë vrarë, e qindra e qindra që kanë mbetur gjallë dhe janë lënë në mëshirën e fatit pa asfarë përkujdesje aqë të domosdoshme. Ndërkomëtarët nuk kanë bërë asgjë për zbulimin e dhunuesve, as edhe përfaqësuesja e tribunalit të Hagës në Kosovë, e cila e ka për detyrë t’i zbulojë e denoncojë kriminelët dhunues serbë”.

Për të kuptuar se sa shtazarake kanë qenë këto dhunime të femrave kosovare nga ushtarët e policët serbë, po pasqyroj vetëm disa grimca të rrëfimeve që pasqyron ky libër. “Ma pushkatuan nënën e vëllanë, kurse mua më dhunuan dhe trupin tim e masakruan për së gjalli me cigare”. Një nga mjeket deklaronte se, “Vajzës së dhunuar i ishte shqyer mitra dhe se në organet

gjenitale i kishin futur rërë, këmbët e gërvishtura dhe mes dy gjinjëve me majën e thikës kishite të vizatuar kryqin serb”. Ose rrëfimet e tjera, “Fëmijët vajtonin mbi trupin e përgjakur të babait të tyre të vrarë, e mua më çnderonin vetëm disa metra larg tij”, “Pasi ma vranë djalin, mua më çnderuan disa ditë me radhë”, “Djalit dy vjeçar ia prenë veshin dhe tre gishtërinj, e pastaj më dhunuan”, “Më dhunuan para syve të nënës”, “Më dhunuan e ma prenë gjirin”, “Cigaren e ndezur e fiki në gjinj të mi”, “Me thikë shkruan fjalë mbi trupin tim, “Më detyronin t’i shiqoja femrat që po i dhunonin me radhë”, “Pasi më dhunuan, m’i hoqën thonjtë me dana”, “Motrën e mbytën me kundak të pushkës”, “14- vjeçarja u dhunua në borë”, “Pasi e dhunuan 13-vjeçaren e hudhën në pus”, “Më çnderuan para syve të babait dhe nënës”, “Në muajin e tetë të shtatëzisë më përdhunoj para vjehrës dhe burrit, e pastaj më goditi në gjoks e në bark dhe linda fëmijë e vdekur”, “Më dhunuan dhe në krah ma vizatuan kryqin serb”, “Pasi i çnderuan tri vajza, ua prenë organet gjenitale”....

Me këto ngjarje trishtuese, të dhimbshme e nga më tragjikat, që se merr mendja e njeriut, duhet njoftuar opinioni botëror për të kuptuar një herë e mirë, se çka u kanë bërë serbët shqiptarëve në Kosovë dhe pse Kosova e meriton pavarësinë.

DIBËR E MADHE – SEDRA E SËMURË SHTON SHPENZIMET GËZIMORE E MORTORE

Besëlidhja dibrane nuk u respektua

Në mjesditet dibrane në vazhdimësi shprehet shqetësimi për shpenzimet e mëdha në ceremonitë e gëzimore apo mortore. Të gjithë habiten pse nuk ndalet ky fenomen i çuditshëm.

Në vitin 2000 në mëse tre mijë familje dibrane u shpërnda teksti i shkruar i Besëlidhjes dibrane me të cilin ftoheshin të gjithë dibranët t’i flakin dukuritë negative e dekadente nga jeta e përditshme, që janë bërë mur i rëndë mbi shpinën e çdo dibrani, dhe të ruajnë e vënë në jetë vetëm zakonet fisnike dibrane. Ishte parashikuar se mosrespektimi i kësaj besëlidhjeje do të kishite përgjegjësi morale kolektive.

Këtë nismë para shtatë vitesh parimisht e përkrahën qytetarët dhe të gjitha asociacionet e pushtetit vendor, partitë politike shqiptare, Dega e Lidhjes së Gruas Shqiptare, Lidhja e Arsimitarëve Shqiptarë, Lidhja e Intelligjencës Shqiptare, Lidhja e Historianëve dhe Myftinia e Dibrës e Madhe, por për fat të keq të gjithë e shkelën këtë besëlidhje fisnike.

Çka paraqiste Besëlidhja dibrane

Flakja e zakoneve dekadente gëzimore e mortore kishte të bëjë me ceremonitë e tepruara me rastin e lindjes së fëmijës, pagëzimit të fëmijës, synetit, fejesës, martesës dhe me rastin e vdekjes.

Me rastin e lindjes së fëmijës ishte parashikuar të njoftohet vetëm rrethi i ngushtë i dy prindërve. Lehonën në spital ta vizitojnë vetëm anëtarët e familjes së ngushtë. Të vazhdohet tradita e dërgimit të petullave në ditën e daljes së lehonës nga spitali, ndërsa të ndërpritet kategorisht praktika e organizim-

it të koktejit te nëna e lehonës. Për fëmijën e porsalindur të organizohet darkë vetëm me dy familjet e miqësuar dhe gjatë pagëzimit të kenë përparësi emrat me prejardhje autentike shqiptare. Dhuratat t’i dërgohen vetëm fëmijës dhe eventualisht lehonës. Dhuratat të dërgojnë vetëm prindërit e lehonës e këto dhuratat të jenë modeste, si krevat fëmijësh e veshmbathje dhe ceremonia për foshnjën e lindur të merr fund natën e emrit. Datëlindjet e fëmijës të festohen në mënyrë modeste, vetëm me shokët e moshës së tyre dhe dhuratat të jenë lodra e libra. Gjatë synetit të fëmijës të përgatitet hallvë për të ftuarit dhe darkë modeste vetëm për rrethin e ngushtë familjar. Dhuratat të jenë vetëm për synetliun. Synetlinjtë të mos dërgohen në varreza, pasi një gjë të tillë e ndalon edhe feja muslimane. Ceremonia e synetit të përfundojë ditën e synetit.

Akti i fejesës, të lidhet edhe me shkues dhe me rastin e ceremonisë të hapet një kuti me llokume apo çokollata. Ndërrimin e nishaneve sipas zakonit duhet ta bëjnë vetëm familjet e miqësuar, dhe në ndërrimin e nishaneve nuses të dërgohet vetëm një unazë e fejesës. Kontakti i parë i familjes së dhëndërit me nusen, duhet bërë në mënyrë shumë modeste e të kulturuar dhe pa dhuratat të shtrenjta dhe shpenzime të kota dhe gjatë periudhës deri në martesë, për festën e Bajramit, 8 Marsin, Vitin e Ri, Shëngjergjin, Maturën të mos dërgohen dhuratat të mëdha.

Me rastin e martesës prindërit t’i japin bijës së tyre si pajë një dhomë fjetjeje me krevat, perde, abazhur, qilim dhe qëndisma të punuara gjatë vajzërisë, dhe të ndërpritet praktika e dhënies së dhuratave të tepruara, si aparate elektrike shtëpiake, pajisje për kuzhinë, dhoma dite etj. Bohçallëqet të përgatiten vetëm

për rrethin e ngushtë të familjes së dhëndërit. Fustani i bardhë i nuses në koshere të merret me qirra në butik, sepse blerja për ta përdorur vetëm për një ditë është jashtë çdo logjike. Numri i fustaneve të nuses në koshere kufizohet maksimalisht në shtatë palë, logarituar edhe kostumet.

Në natën e kumutrisë duhet kufizuar sasinë e sheqerkave, llokumeve e çokollatave. Të ndërpritet praktika e obligimit që çdo pjesëmarrës në dasmë të dhurojë një shumë të konsiderueshme të hollash për darkën në të cilën do të ftohet. Kurorëzimi i çiftit të ri të bëhet në ambientet e Bashkësisë Islame, duke qenë pjesëmarrës vetë çifti dhe jo i shoqëruar nga të tjerët. Sipas traditës dibrane, kokat për nusen e re të organizohen në shtëpi në një rreth të ngushtë dhe me shpenzime të vogla. Darka “mik së pari”-përviçeja të mbahet si e tillë.

Me rastin e vdekjes, nga aspekti fetar islam është gjë e tepruar të shprehen vajtime dhe britma shurdhuese. Darkat për të vdekurin dhe të ftuarit me lista të posaçme dhe të shtruar në restorante nuk janë të preferueshme. Përkujtimet për të vdekurin, 6 javët, 6 muajt, mot-

moti, të mbahen në xhami dhe jo me rituale në shtëpi.

Këto ishin normat e parashikuara të Besëlidhjes dibrane për të flakur zakonet dekadente dhe të tepruara, e për të ruajtur pastërtinë e zakoneve shqiptare dibrane nga çdo ndikim i jashtëm.

Vazhdon avazi i vjetër

Për fat të keq sot e kësaj dite, në qindra e qindra ceremoni gëzimore e mortore, lere që nuk është zvogëluar gjë, por dita ditës shtohen edhe bidate tjera. Nga sedra e sëmurë askush nuk e ka marë guximin që së paku në ftesën për darsëm të shënojë që dasmori ta konfirmojë pjesëmarrjen. Kjo për asgjë tjetër, por vetëm të mos ndodh, siç po ndodh, që për arsye të ndryshme me dhjetëra darsmorë të mos vijnë në darkë dhe shpenzimet dhe ushqimi të shkojnë kot.

Për të gjitha këto ceremoni shpenzohen qindra mijëra dollarë apo euro. Do të ishte mirë sikur këto ceremoni gëzimore e mortore të bëhen me më pak shpenzime, si për ata që janë në kurbet dhe për ata që për ceremoni të madhe e pompoze hyjnë edhe borxh.

Rexhep TORTE

NJOFTIM

Me rastin e botimit të edicionit të ri të kalendarit “Dibra 2008”, ftojme fotografë profesionistë dhe amatorë të marrin pjesë në konkursin e hapur me këtë rast me fotografi nga vende të ndryshme të Dibrës. Fotografitë do të përzgjidhen nga një juri fotografësh, dhe fotot që do botohen do të shpërblehen.

PËR KONTAKT: Tel: 069 20 68 603.

E-mail: mbbotime@gmail.com; djmenny@gmail.com

VISARE NGA ODA DIBRANE / FJALË NË SEPETE



Nga NAIM PLAKU

Qitapi i Hoxhë Nelës



se...

-Martuar dhe me fëmijë, bile. S'e luan topi.

Gruas iu prenë këmbët, iu morën mendët dhe u këput si degë bajameje e ra në krahë të hoxhës. Apo s'ishte si perri, apo s'ishte si yll, apo s'ishte si bjeshkë?! U kullot Nela pak kohë me kurmin plot aromë ftuje dhe pas pak, kur u përmend, u shkëput nga krahët, grumbulloi fuqitë e shpërtheu:

-Shife mirë Qitapin, o hoxhë Kalisi, se...

-Qitapi të jep udhë... Kujtoje ëndërrën, dikush të ka në krahëror... Të ka dhënë udhë nuni, martoju e... dhe deshi ta fusë përsëri në krahëror, ta përkëdhelte e ta zejë gjumi si shqerrë në krahët e tij.

-Shife mirë Qitapin, se...

Gruaja, si një kuçedër kishte përtaqësi dhe e skuqur në zjarri e vatrës dhe po i përcëllonte mjekërinë e zezë hoxhës. Një erë e rëndë nisi të përhapet në konak, si era e cjaminë në vjesh-të. Qitapi kishte fluturuar nga duart e Nelës dhe fletët e verdha ishin shpërndarë tej e tutje si gjeth shlep. Kapakët e Qitapit dergjeshin në këmbët e hoxhës. Se si fluturuan e u përtharë gjithë ata emra me bëmat e tyre, me të lartat e të palarat, si të ishte një pallat ëndërrash i ndër-tuar me pare të vjedhura, haram.

Por çudi e madhe... Emri i Qitapit të hoxhë Nelës nuk ka vdekur e nuk vdes kurrë.

Shpjegime fjalësh e shprehjesh

- 1)Hërkë-a,-at. Veshje e sipërme e klerikut mysliman, një lloj pardesyje që e bën të dallueshëm si udhëheqës fetar.
- 2)Tuxhar(arkaizëm)-tregtar
- 3)Vaz-predikim që bën hoxha në xhami.
- 4)Me mazdape- me dokumente.
- 5)Buson-nxjerr ujë, lëng, burim i vogël, rrjedhje me pakicë
- 6)Shitblerje-qarkullim i mallrave brenda ditës.
- 7)Tabijate, nasihatë(trq.)-zakone, sjellje, moralitete
- 8)Gërdhuz,em,fol.-përmbledh dikë, kërcënoj me forcë dikë, i gërdhuzem.
- 9)Vizhdani e kazani- as mideja, as stomaku, s'ma mban trupi.
- 10)Arabeska- Të ngajshme me shkrimin arab, hieroglifë, arabeska, si të arabëve.

Nela, atë që mësonte prej Qatipit, ia shiste Zabitiit. Disa filluan t'i besojnë, sidomos shqiptarët fakirë që mblidheshin çdo mbrëmje te xhamia e Pëllumbave. Filluan ta thërrasin hoxhë, ndoshta edhe pse mban-te në kokë atë biçim kësule ku vendoste tepsinë e hallvës që të mos i vriste kokën.

Disa fati i ndjek pas, u buzëqesh, siç thonë. Kështu i buzëqeshi një ditë dhe Nelës, që u gdhi vërtet hoxhë. Në podrumet e Kapllan Hallvaxhiut, ku flinte, gjeti një libër të trashë fort, me ca shkrime të ngatërruara, me ca fletë të verdha e të këputura, me ca kapakë të përlyer, që Nela e quajti Qitap, ku ndodhej e fshehur brenda atyre kapakëve gjithë mendja e ndritur e njerzimit. E mori, e pastroi pak, e shfletoi shkarazi, e futi në gjë dhe e ruante me kujdes si të ishte vula e Sulltanit. Se ç'kishte brenda Qitapi, se dinte as hoxhë Nela. Dikush thoshte se janë emrat e borxhlinjve të Kapllan Hallvaxhiut, dikush se është Qitapi i Kuzhinës së Grave të Haremit, ndonjëri, si më i guximshmi, thoshte se është "Teferi i zinaçinjëve", që i përkthyer në shqip do të thotë i përdhunuesve, se aty vërtet kishte gjetur emrin e sevдалиut të përvëlur të ish gruas së nallanxhiut të Portës. Në të vërtetë, ky Qitap ishte i mbushur plot emra të çuditshëm, që kishin bërë vepra të mëdha, por ishin aq të vockël, sa u bënte hije urofi. Kush u jepte dum, se?

Një ditë brofi te hoxha një burrë trashalug, i kuq flakë e t'ju gërdhuz⁶⁾ hoxhës:

-Ku ma ke Qitapin, Nelë, se të hëngra?!

-Më ha, s'më ha, Qitap as kam, as jap, - iu gjegji shkurt Nela.

-Nelë vëllai, - u zbut trashalug, - aty kam tërë miqtë e shokët e kësaj bote, të gjallë e të vdekur, të këndshëm e të pakëndshëm, të bardhë e të zinj, që në ditë të mira e të vështira më hodhën nga një metelik në xhepin e jelekut...

-Lëshoju një rahmet! - i tha qetë-qetë Nela atij burrit, që mbahej si pronari i Qitapit. Se Nela ishte i ashpër kur ia deshte vizhdani e ia pranonte kazani⁹⁾.

Kështu ngeli Qitapi në dorën e Nelës, që i dha emër e zë. Megjithëse nuk dinte të lexonte e të shkruante, hoxhë Nela, pa ç'pa e la tepsinë e hallvës dhe u mor me leverdinë e Qitapit. Dilte në shesh të xhamisë së Pëllumbave me të në dorë dhe në një kënd të fshehtë ku mblidheshin shqiptarët që donin të lexonin fatin e tyre, hapte ngadalë Qitapin dhe u jepte habere nga dheu i tyre, nga familja, nga Dibra e Luma mbarë:

-Po bën dimër i egër andej nga ne. Kanë ngordhur shumë bagëti.

-Gjynah, po na tret dhe i huej, po na lëpin kockat.

-Të është mërziur shumë nëna, o trim. Bëhu pak i gjallë! - i thoshte tjetrit.

Të paskan zënë një nuse të mirë, o çakmak, - lexonte në Qitap për të riun.

-Aman, hoxhë, më shkruaj dy gisht letër për prindërit! - lutej fakiri.

-Hape Qitapin, hoxhë, e kam gjallë babën? - lutej tjetri.

Hoxhë Nela nuk përtonte. Hapte Qitapin e u nxirrte merakun. U shkruante letra me ca arabeska¹⁰⁾ të çuditshme, ashtu byk e kashtë, i mbështille rul, i lidhte me një konop të trashë dhe u thoshte që pas një muaji të vinin e të merrnin përgjigjen. E fuste letrën në një torbë lëkure dhe u fliste me dorën e djathtë:

-Iku, shko! - Me dorën tjetër fuste metelikun në xhepin e majtë.

Si i doli boja kësaj ane, tha t'i kthejë njëherë anës tjetër. Bëri ç'bëri mori pampurin e çau për në atdhe, ashtu siç tham, me këtë Qitapin e rëndë në duar, me hërkë jeshile e me çallmën e bardhë, me një barrë mend në kokë për t'i ardhur në ndihmë vatanit fukara. Simpatia kishte arritur gjër atje sa shumë nëna uronin t'iu dërgonte Allahu një djalë të mbarë e

hallall si hoxhë Nela.

Ja tek e kemi hoxhë Nelën me Qitapin e tij përsëri në Kalis. Përkthen letrat që vijnë nga Anadoli, u kthen përgjigje e fap në dollap, i poston. Hap Qitapin, parasheh të ardhmen, shqyrton të kaluarën, vlerëson, merr, jep, blen e shet, shpik e shpif histori, ha e pi, qesh e luan, bën lesh e li... Poooo, hoxhë Nela! Shkruan hajmali, lidh e zberthen magji, mbledh e përzë xhind, largon të paudhët, fryn e trazon ujërat. Dhe paret i bijen prej oxhaku drejt e në prehër. "E paskam pasur Stambollin te dera" - thoshte me vete. Në ndonjë çështje me siklet përtypet thellë dhe, si me nxjerrë një gozhdë të ndryshkur nga dërrasa e vjetër, tund kokën e thotë:

-E vështirë boll, por motra ka motër, - dhe hap Qitapin. - Ja ku është! Vetëm ky s'të rren, - dhe ve dorën mbi kapakët e lyrosur të Qitapit.

Por punët nuk shkojnë fjollë përherë. Kishte ndonjë kopil Kalisi që e kishte kapur pisk hoxhën. Njëherë e vunë re se po lexonte një letër së prapthi. Një grua mandatin e vdekjes së burrit ia kishte përkthyer si të ishte një çek për të tërhequr pare, një djalë i ri vdiq se hoxha i kishte thënë se e kishin pushtuar xhindet e duhej të rrinte një ditë e një natë lakuriq jashtë, që t'i largoheshin të padukshmit, etj... Por ajo që ia lëshoi bojën përtokë ishte përkthimi që i bëri letrës që ia solli gruaja e nunit dhe shpjegimi i ëndërrës së frikshme që kishte parë e gjora, sikur ishte rrëzuar nga një kep i lartë, por nuk ishte vradë, se dikush e kishte mbajtur në krahëror.

-Aman, nun, aman hoxhë Nela, më thuaj rron apo nuk rron? - e kishte pyetur ajo.

-Rron, por si rron, moj burmëshë?! - i thotë hoxha duke hapur Qitapin.

-Si rron? - pyeti përsëri duke u dridhur gruaja e nunit.

-Hëëë, rron, por si rron?! Si faqja e zezë rron... - ngriti kokën hoxha. -Të është martuar, belaja...

-Shife mirë, o hoxhë Neli,

Një libër për udhëtimin e cilësishëm


Nga ALEKSANDËR ÇIPA

Në publicistikën e sotme të vendit hasen dy tendenca: humbja e disa zhanreve për shkak të vetë publicistëve në shtypin e përditshëm dhe atë periodik dhe rishfaqja e tyre në pamjen e librave me ese dhe reportazhe. Për prurjen e llojit të dytë, prej kaq vitesh ka një vëmendje të paktë. Janë shumë libra të sjella në tregun e leximit shqiptar prej emrave të njohur dhe të shumëshpallur, sikundër edhe prej disa të tjerëve, të cilësuar për punëtorë të zellshëm të informimit dhe të shtypit. Grip Troci hyn në kategorinë e punëtorëve, që në imazhin më të mirë të modestëve, pohon sipas sentencës latine të vërtetë: "Verba volant, scripta manent". E shkruara mbetet... "Një kafe në Kullën Eiffel", mbetet si mbresë e formësuar, si një përzgjedhje prej modestisë së vetvetes dhe prej shqisave vetiake që ka publicisti. Autori i këtij libri është një udhëtar i përditshëm, një udhëtar që kërkon

jo vetëm perimetrin e së përditshmes, në një vizion të kufizuar, por në një perimetër që nis në hapësirë globale dhe mbetet i qasshëm gjithmonë me realitetin.

Reportazhi që emërton këtë libër, është një itinerar i thjeshtë, një lëvizje e zakonitë e cila nën filtrin e një gazetari, pasqyron bashkimin e ndjesisë me refleksionin e qytetarit që adhuron kontinentin e vet dhe kryesisht, hapësirën metropolitane të qendrës së këtij kontinenti në këtë konstatim, ne i mësojmë dimensionit mental që mbar reportazhi, përmes të cilit gjejmë një mori ikanakësh me pamje dhe ndërgjegje sociale, me botë dhe tipologji kombëtare, me inat dhe mëzri periferie, por me gaz dhe lëvdim kozmopolitësh. Janë këto karakteristikat e zbuluara prej Garip Troci në reportazhin drejt asaj Kulle e cila për dekada me radhë, zgjoi mirazhe nëpër breza shqiptarësh. Reportazhi është një filtrim i kontrastit që ndjen dhe evi-denton autori, ndërsa vijon një itinerar të zakonshëm udhëtues, nga breg-

deti i Adriatikut, me portnasje Durrën e deri sa mbërrin në Kullën që simbolikën e emrit e ka më të lartë se lartësia fizike. Ky është tacionimi i parë, prej të cilit reporteri Troci, gjen një kumt të thjeshtë, por mbetës. Në kaptinën tjetër të librit, është selektimi i një pjese tjetër kontaktesh që autori ka patur profesionalisht. Janë emra dhe personazhe që realisht në përditsh-mërinë e shoqërisë sonë sjellin valencën e përfaqësuesve, të inteligjen-cies dhe të vlerave njerëzore. Ky kapitull është dëshmi për pjesën më aktive të jetës profesionale të autorit. Antologjia e personazheve të sjella në këtë pjesë të librit, përmes zhan-reve të ndryshme publicistike, flasin për një tendencë gjeruese të galerisë dhe gjeografisë së kontaktit që synon dhe mundet të ketë autori. Në ka-pitullin e tretë, libri "Një kafe në Kullën Eiffel", sjell intervista dhe refleksione në miniaturë për aspekte të ndry-shme të aktualitetit. Në këtë kapitull autori tenton të fitojë një dimension të vetin qasës. Janë qasje të cilat veço-



hen për qëndrimmbajtje dhe për vetë deklarim qytetar. Në këtë libër, lexuesi kontakton me shumë njerëz, me shumë hapësirë dhe merr imazhe për shumë stacione rurale, urbane dhe metropolitane. Kjo është e cilësishme. Ky libër është një sjellje e tendencës për udhëtimin e cilësishëm që kushdo tenton ta kryejë se ka gjallje.

Gjetan Keta, fitues i Turneut European në K1-Rules, Thai & Kickbox

Gjetan Keta, dibrani 24 vjeçar, është shpallur fitues i Turneut European në K1-Rules, Thai & Kickbox, që u zhvillua në Tiranë më 29 shtator 2007 në Pallatin e Sportit "Aslan Rusi".

Gjetan Keta është një sportist, i cili stërvitet prej katër vitesh në Gjermani nga i vëllai i tij, Ismail Keta, ish nënkampion bote në këtë sport.

Mijëra spektatorë në Pallatin e Sportit, por edhe të gjithë ata që e ndoqën në ekranin e Televizionit Publik Shqiptar, u mrekulluan dhe u emocionuan nga paraqitja mjaft dinjitoze që bëri Gjetan Keta, i cili fitoi me nokaut ndeshjen e parë me kundërshtarin turk, ndërsa me pikë ka mundur rivalin polak në finale.

Duke njohur forcën e tij, kundërshtari rus nuk u paraqit në turin e dytë.

Ky turne zhvillohej në Shqipëri për herë të parë, me një organizim të shkëlqyer të vëllait të kampionit, Ismail Keta, i cili është një trajner në këtë sport në Gjermani. Në Mynih ai drejton një Akademi Sporti, ku stërviten mbi 400 sportistë. Në këtë turne morën pjesë 7 shtete: Greqia, Polonia, Rusia, Shqipëria, Gjermania, Turqia, Italia.

Gjetan Keta, pas fitores së Kupës në Tiranë, është kualifikuar automatikisht për në Kampionatin Botëror, që do të zhvillohet më 29 nëntor në Tailandë.

Gjetan dhe Ismail Keta janë fshati Koçaj i Bulqizës.

Gjetani ka qenë emigrant në Greqi, por para katër vitesh vendosi të nisë këtë sport, falë cilësive të tij sportive, por edhe dëshirës së vëllait, një ish nënkampion bote në këtë sport.

Gjetani ka zhvilluar deri tani 32 ndeshje dhe ka fituar 26, prej të cilave 13 me nokaut. Pas fitores së këtij titulli europian, ai është pritur si hero në vendlindje, duke u shpallur edhe "Qytetar Nderi" në Fushë-Bulqizë, ndërsa bashkia e Bulqizës e ka nderuar me titullin: "Mirënjohje e qytetit".

Dy vëllezërit Keta tashmë po përgatiten për Botërorin e Tailandës, duke synuar të fitojnë një titull botëror për ngjyrat e kombit shqiptar. Dy vëllezërit Keta janë për t'u respektuar, pasi nuk kanë pranuar të luajnë për asnjë vend tjetër,



perveç ngjyrave të Flamurit Kombëtar. Ofertave të majme nga Gjermania, Holanda dhe Greqia u kanë kthyer një "JO" të prerë, megjithëse nga shteti shqiptar në këtë turne nuk kanë gjetur asnjë mbështetje, përveç disa zyrtarëve të Ministrisë së Jashtme. Gjetanin kampion dhe vëllanë e tij nuk i priti asnjë nga zyrtarët e sporteve në Shqipëri, duke treguar me këtë rast se asnjëri prej tyre nuk e njeht sportin në përgjithësi, dhe sidomos K1-Rules, një sport që nuk është vetëm Boks, por që njihet mbarëbotërisht si Arti i Boksit.

Le t'i urojmë talentet dibranë të kenë fat në Tajlandë, duke u kthyer me Trofeun Botëror!

Fiqiri Rama, mjeshtër i sportit shqiptar

Kudo ku të pyesësh në qytetin e vogël të Peshkopisë për Fiqiri Ramën e njohin dhe flasin me respekt të veçantë i cili prej vitesh drejton ekipin e mundjes së lirë me klubin sportiv "Korabi". Një njeri trup vogël, i dashur dhe respektuar nga të gjithë, me një komunikim që të bën përshtypje, e shikon në shëqitoren e qytetit jo vetëm por gjithmonë rrethuar me miq e shokë të shumtë. Ishte viti 1972 kur Fiqiri atëherë sapo kishte mbushur 18 pranvera ra në qytetin e bukur të Peshkopisë. Erdhi në këtë qytet që tashmë është lidhur ngushtë me të pas një pune të gjatë në qytetin e Burrelit. Të parët e tij ishin mjeshtër në ndërtim. Kështu dhe Fiqiri i vogël mori s'qeparin me vete dhe u bashkua babait të tij duke punuar për vite me radhë bashkë, babë e bir. Tek djaloshi gollobordas përveç pasionit për punën si ndërtues, sporti i dashur i mundjes kishte filluar të spikaste tek moshatarët e tij por dhe tek më të rriturit. Shpejt i ra në sy edhe trajnerit të atëherëshëm të mundjes së lirë Ismet Elezit. Ishte viti 1972 dhe që nga ky vit Fiqiri Rama nuk i është ndarë për asnjë çast ekipit të Korabit. Fiqiri që i vogël kur jetonte në fshatin e lindjes në Radovesh kishte dëshirë të bëhej një mundës i mirë. Kjo dëshirë e tij merret shkas nga dasmat në Gollobordë kur nga lojrat e shumta, sporti i mundjes ishte ndër më kryesoret. Dhe ishte ndeshur disa herë Fiqiri i vogël me moshatarë në këto dasma. Talenti i tij spikati në Peshkopi, por dhe

kariere prej mundësi këtu nisi, ndaj sot e ka të vështirë ta braktis këtë qytet se bashkë me Peshkopinë braktis dhe ekipin e mundjes "Korabi" pranë të cilit ka gati një jetë të tërë. Nga viti 1995 e sot është vetë trajner për ekipin e "Korabit". Fakt është se Fiqiri për njëzet vjet me radhë shpallet kampion Ende e kujton ndeshjen në pallatin e sportit "Aslan Rusi" Ishte viti 1995 tregon Fiqiri dhe sapo isha kthyer nga një kampionat që zhvilluam në Stamboll. Shorti më ra mua të ndeshem me tim bir Gazin që ndesheshim për ngjyrat e "Korabit" Ishte vërtet diçka e veçantë por shorti ishte i tillë që do të ndesheshin të dy Ramët, i riu me të vjetrin. Fati qëllloi me mua. Rama i vjetër fitoi por unë këtë ndeshje ende e kam të freskët në kujtesë.

Tashmë Fiqiri Rama ka plot një çerek shekulli që është trainer i ekipit të mundjes me ekipin e "Korabit" dhe ky ekip sot për sot është ndër më të mirët në shkallë vendi.

-Kanë lëvizur shumë veta, bile dhe nga miqtë e mi drejt Tiranës, unë jo dhe as që pretendoi të largohem njëherë, -thotë Fiqiri. Më dhimsen ekipi i mundjes se dhe pse në kushte të vështira stërvitje kemi korrur herë pas here fitore. Jeta ime është e lidhur tashmë me këtë qytet dhe sportin e mundjes. Fiqiri edhe pse është mjaft kërkues ndaj vetes dhe sportistëve kur vjen puna tek pushteti lokal nuk kërkon shumë.

-Punojmë në kushte të vështira por nuk mund të kërkojmë

shumë nga bashkia. Nuk kanë dhe ne nuk kemi se çfarë t'ju marrim. Megjithse ekipi i mundjes ka ardhur në Peshkopi disa herë kampion dhe me flamur e medalje përsëri pushteti lokal nuk ka bërë sa duhet. Jemi munduar të bashkëpunojmë me biznesin e Dibrës, thotë Fiqiri dhe ato na kanë mbështetur me aq sa kanë patur mundësi. Sot nuk kemi qoftë dhe një tapet për stërvitje por kemi një dyshek që e përdorim në vend të tapetit. Fiqiri disa herë ka pësuar dhe aksidente por kurrë nuk u ankua por ashtu i aksidentuar ka marrë pjesë në gara. Kujton se gjatë një stërvitje që do të ndeshesh në Durrës nxorri brylin e dorës së djathtë. Ashtu me një dorë vajti në Durrës, u ndesh dhe fitoi duke u shpallur kampion. Edhe dy ditë para një ndeshjeje në Elbasan Fiqiri ishte aksidentuar gjatë pregaditjeve në gju. Ashtu siç ishte zhvilloi kampionatin dhe Fiqiri Rama u shpall mundësi më i mirë. Këto janë një opjesë e atyre ngjarjeve dhe ndodhive në jetën e mundësit të talentuar Fiqiri Rama

Fiqiri ka marrë disa medalje dhe tituj si "mjeshtër i merituar i sportit", "nderi i klubit sportiv "Korabi" si dhe tani në fund edhe "Nderi i sportit shqiptar". Duke parë aftësitë e tij Fiqiri Rama shpesh herë është trainer dhe me ekipin kombëtar të mundjes. Dhe asnjëherë nuk i ka zhgënjyer. Fiqiri padyshim është nderi dhe krenaria e sportit të mundjes në qytetin e Peshkopisë, dhe kështu do të kujtohet vite me radhë.

Mirvet Lala

DIBËR E MADHE- Përfundoi turne mbarëkombëtar "Pavarësia" i veteranëve të pingpongut

Dominuan pingpongistët kosovarë

Në organizim të Klubit të pingpongut "Dibra"-Dibër dhe me mbështetjen e Federatës së Pingpongistëve të Maqedonisë dhe të Federatës Mbarëkombëtare të Pingpongistëve-Tiranë, më datë 20-21 tetor 2007 në Dibër të Madhe u mbajt Turne mbarëkombëtar i pingpongistëve veteranë shqiptarë me moton "Pavarësia", i dhjetë me radhë, në të cilin morën pjesë veteranët e pingpongut nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia.

Në gara morën pjesë 48 garues, prej tyre 15 nga Shqipëria, 22 nga Kosova dhe 9 nga Maqedonia. Garat u zhvilluan në tri grupmosha.

Sipas rezultateve të shpallura në grupmoshën mbi 60 vjeç në garat teke, vendin e parë e zuri Shaip Reçica dhe vendin e dytë Xhemal Çeçelia. Në grupmoshën 50-59 vjeç, vendin e parë e zuri Burim Rakovica dhe vendin e dytë Ferit Bajrami. Në grupmoshën 40-49 vjeç, vendin e parë e zuri Nehat Çitaku dhe vendin e dytë Jonuz Tufa.

Në garat dopjo në grupmoshën deri 60 vjeç vendin e parë e zuri Sherafedin Zhitija dhe vendin e dytë Avni Jashari. Në garat dopjo prej 30 deri 40 vjeç vendin e parë e zuri Nehat Çitaku dhe vendin e dytë Burim Rakovica.

E veçanta e këtij turne ishte se në këto gara morën pjesë edhe garuesit e moshës 73 vjeçe, Shemi e Lutfi Manjani nga Dibra e Vogël-Peshkopia. Në këtë turne ishte garues edhe Burim Rakovica, i cili jeton dhe punon në Zelandën e Re dhe atje është kampion i pingpongut.

Garuesve që morën vendet e para ju dorëzuan diploma dhe kupa të turneut, garuesve që zunë vendet e dyta iu dorëzuan diploma, ndërsa garuesve që zunë vendet e treta e të katërta iu dorëzuan vetëm mirënjohje.

Dr. Sadri Hulaj, kryetar i Federatës së veteranëve të pingpongut në Kosovë, duke u shpallur fituesit, shtoi se, "Jemi të magjepsur me bujarinë dhe mikpritjen dibrane për të cilën kishim degjuar nga prindërit tanë që kur ishim fëmijë e tani e përjetuam edhe vetë. Nga viti në vit numri i pjesëmarrësve të veteranëve shqiptarë të pingpongut se vjen e shtohet në të mirë të sportit e kombit. Falenderoj sportistët për garat e mirfillta sportive dhe referet për punën e tyre të shkëlqyer në kaktimin e pikëve. Falenderoj Argëtim Fiden, kryetarin e komunës së Dibrës për idenë që ky turne të pagëzohet "Pavarësia", si edhe për mbështetjen financiare, sëbashku me Banjat e Dibrës-Capa, Fabrikën e Gjipsit "KNAUF", Pronarin e Fabrikës "Diplast", Agjensionin "Hisar Turist", Ndërmarrjen "Engji", Ndërmarrjen "Valmira" etj. Falenderoj organizuesit, Ylber Dacin, kryetarin e Klubit të pingpongut "Dibra"-Dibër, aktivistin Jakup Marku dhe shumë të tjerë".

Argëtim Fida, kryetar i komunës së Dibrës, duke përshëndetur fillimin e këtij turne, deklaroi se: "Premtimin se turneun e dhjetë do ta mbajmë në Dibër e realizuam. Arsye pse organizohet Turne mbarëkombëtar i veteranëve të pingpongut, të këtij sporti kaqë fisnik janë të shumta. Sporti dhe kalitja e trupit kthellojnë edhe mendjen. Në këto çaste vendimtare të gjithë shqiptarët duhet ta kenë mendjen shumë të

kthjellët, sepse edhe emri dhe mesazhi i turneut është pavarësia, pasi që çasti që është pritur gati një shekull që shqiptarët në Kosovë ta gëzojnë pavarësinë po afrohet. Dëshiroj kështu sëbashku si edhe kombet e tjera të gëzojmë edhe të drejtën tonë legjitime për të jetuar e vepruar si tërë kombet e tjera të mëdha", ndërsa në përfundim të këtij turne, duke u falenderuar për mbarëvajtjen e këtij turne, Fida, theksoi se, "Falenderoj tërë sportistët pjesëmarrës në



Argëtim Fida duke përshëndetur fillimin e turneut



Shkëlqim Hoxha dhe veterani Buri Rakovica nga Zelandia e Re.

këtë turne, falenderoj biznesmenët dibranë për gatishmërinë e tyre në mbështetjen e këtij turne, të cilët mundësuan që të jemi këtu sëbashku nga shumë troje shqiptare, që edhe nëpërmjet këtyre aktiviteteve të vazhdojmë dhe punojmë për bashkimin e traditës, kulturës dhe sportit".

Shkëlqim Hoxha, përfaqësues i Federatës mbarëkombëtare të veteranëve të pingpongut të Shqipërisë, njëri nga promotorët dhe organizuesit të këtij turne, tu shpreh se: " Kam kënaqësinë të deklaroj se historikisht majat e suksesave të pingpongut në Tiranë i kanë mbajtur dibrano-tiranasi gjatë disa gjeneratave. Zanafilla e këtij turne mbarëkombëtar i veteranëve të pingpongut në hapësirat shqiptare, është pas vitit 1999 dhe luftës në Kosovë. Për shkak se kosovarët erdhën në Tiranë si refugjatë dhe atje filloi procesi i bashkëjetesës, i integritit, i qarjes së halleve. Në ambientet tona sportive u shfaqën pingpongistët të Kosovës, të Tiranës dhe atje patëm njohjen e parë dhe bëmë një turne lokal. Kështu vendosëm që turneun e nëntorit të vitit 1999 ta mbajmë në Prishtinë. Pas kësaj turnetë u mbajtën në Tiranë, Shkodër, Ferizaj, Durrës, Gjakovë, Peshkopi, Prizren, Kaçanik dhe tani e mbajmë turneun e dhjetë jubilar në Dibër të Madhe. Do të angazhohemi që në të ardhmen e shpejtë këtë turne ta shtrijmë në tërë trojet shqiptare dhe pse jo edhe shtetet e tjera të Ballkanit".

Në drekën e përbashkët jehoi kënga e vallja si shprehje e vëllazërimit kombëtar dhe e efektit fisnikëruar që sjell sporti me mesazhin që të rinjtë këtë rrugë ta vazhdojmë edhe më vullshëm dhe me më shumë suksese.

R. TORTE